



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BURIMET
E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË (PKVBRE)
2011 - 2020**

KOSOVË, 2013

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKËS PËR BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	4
2. PARASHIKIMI I KONSUMIT FINAL TË ENERGJISË 2010-2020	11
3. CAQET DHE TRAJEKTORJA E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME	15
3.1. CAKU I PËRGJITHSHËM.....	15
3.2. CAQET INDIKATIVE SEKTORIALE.....	16
4. MASAT PËR ARRITJEN E CAQEVE	21
4.1. PASQYRË E TË GJITHA POLITIKAVE DHE MASAVE PËR PROMOVIMIN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME.....	21
4.2. MASAT SPECIFIKE PËR TË PËRMBUSHUR KËRKESAT SIPAS NENEVE 13, 14, 16 DHE NENEVE 17 DERI 21 TË DIREKTIVËS 2009/28/EC.....	30
4.2.1. Procedurat administrative dhe planifikimi hapësinor (neni 13(1) i Direktivës 2009/28/EC).....	30
4.2.2. Specifikacionet teknike (neni 13(2) i Direktivës 2009/28/EC).....	35
4.2.3. Ndërtesat (neni 13(3) i Direktivës 2009/28/EC).....	36
4.2.4. Ofrimi i informatave (nenet 14(1), 14(2) dhe 14(4) të Direktivës 2009/28/EC).....	37
4.2.5. Certifikimi i instaluesve (neni 14(3) i Direktivës 2009/28/EC).....	38
4.2.6. Zhvillimi i infrastrukturës elektroenergetike (nenet 16(1), 16(3) dhe 16(6) të Direktivës 2009/28/EC).....	38
4.2.7. Operimi i rrjetit elektroenergetik (neni 16(2) dhe 16(7) dhe (8) i Direktivës 2009/28/EC).....	42
4.2.8. Integrimi i biogazit në rrjetin e gazit natyror (neni 16(7), neni 16(9) dhe (10) i Direktivës 2009/28/EC).....	43
4.2.9. Zhvillimi i infrastrukturës për ngrohje dhe ftohje qendrore (neni 16(11) i Direktivës 2009/28/EC).....	44
4.2.10. Biokarburantet dhe biolëngjet tjera – kriteret e qëndrueshmërisë dhe verifikimi i pajtueshmërisë (nenet 17 deri 21 të Direktivës 2009/28/EC).....	45
4.3. SKEMAT MBËSHTETËSE PËR TË PROMOVUAR SHFRYTËZIMIN E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË.....	47
4.4. SKEMAT MBËSHTETËSE PËR PROMOVIMIN E SHFRYTËZIMIT TË ENERGJISË SE FTOHJES DHE NGROHJES NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME.....	50
4.5. SKEMAT MBËSHTETËSE PËR PROMOVIMIN E SHFRYTËZIMIT TË ENERGJISË NË TRANSPORT NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME.....	51
4.6. MASAT SPECIFIKE PËR PROMOVIMIN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BIOMASA.....	52
4.6.1. <i>Furnizimi me biomasë: për nevoja vendore dhe për eksport</i>	52
4.6.2. <i>Masat për rritjen e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë parasysh shfrytëzuesit tjerë të biomasës (sektorët e bazuar në bujqësi dhe pylltari)</i>	56
4.7. PËRDORIMI I PARASHIKUAR I TRANSFEREVE STATISTIKORE MES PALËVE KONTRAKTUESE DHE PJESËMARRJA E PARASHIKUAR NË PROJEKTE TË PËRBASHKËTA ME PALË TJERA KONTRAKTUESE DHE ME SHTETE TË TRETA.....	58
5. VLERËSIMET	59
5.1. PJESËMARRJA E PËRGJITHSHME E PARASHIKUAR NGA TEKNOLOGJITË E NDRYSHME TË ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME PËR ARRITJEN E CAQEVE OBLIGATIVE TË VITIT 2020 DHE TRAJEKTORËN INDIKATIVE TË PËRKOQSHME PËR ENERGJINË ELEKTRIKE, TË NGROHJES DHE FTOHJES DHE TRANSPORTIT NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME.....	59
5.2. PJESËMARRJA E PËRGJITHSHME E PARASHIKUAR NGA MASAT PËR EFIÇIENCË DHE KURSIM TË ENERGJISË PËR T'Ë PËRMBUSHUR CAQET E OBLIGUESHME 2020 DHE TRAJEKTORËN E PËRKOQSHME INDIKATIVE PËR PJESËN E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME NË ENERGJI ELEKTRIKE, NGROHJE DHE FTOHJE DHE TRANSPORT.....	67
5.3. VLERËSIMI I NDIKIMEVE (OPSIONALE).....	69
5.4. PËRGATITJA E PKVBRE DHE PËRCJELLJA E ZBATIMIT TË TIJ.....	69

SHKURTESAT

UA	Udhëzim Administrativ
F	Ftohje
KE	Komisioni Evropian
EE	Efiçienca e Energjisë
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
FiT	Feed-in Tarifa
HC	Hidrocentral
N	Ngrohje
PVKEE	Plani i Veprimit i Kosovës për Efiçencë të Energjisë
SKSHE	Sistemi i Kosovës për Shpërndarje të Energjisë
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) dhe Operatori i Tregut (OT)
PKEEBRE	Programi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtërishme të Energjisë
ktoe	Kiloton naftë ekuivalent
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MZhE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PKVBRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
FP	Furnizuesi publik
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
HCV	Hidrocentrale të vogla
Tr	Transporti
BB	Banka Botërore
BP	Bashkëprodhimi

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE PËR BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Korniza strategjike

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) përbëjnë një komponentë të rëndësishme të sektorit të energjisë në Kosovë. Ato trajtohen nga një kapitull i veçantë i Strategjisë së Energjisë së Kosovës 2009-2018. Përbushja e parashikimeve për prodhimin e energjisë nga BRE përbën objektivat afatgjatë për realizimin e tri qëllimeve të politikës energjetike të vendit siç janë: mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritja e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtja e mjedisit. Kjo *Strategji* synon themelimin e masave stimuluese fiskale dhe financiare për të gjitha llojet e BRE, si dhe sistem të certifikatave të gjelbra. Bazuar në *Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2009-2018* dhe kornizën ligjore, në Kosovë është vendosur një sistem i tarifave feed-in për të nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ujit, era dhe biomasa, duke përfshirë biogazin. Kjo *Strategji e energjisë* i kushton vëmendje të veçantë miratimit të plotë të politikës së BRE-ve të Bashkimit Evropian (BE), përmes përbushjes së të gjitha obligimeve që dalin nga *Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE)*. Strategjia vë theks të veçantë hidrocentralit Zhur dhe potencialeve të ujit përmes hidrocentraleve të vogla.

Kosova, gjithashtu ka miratuar *Strategjinë për Ngrohje Qendrore 2011-2018*. Burimet e ripërtëritshme të energjisë trajtohen në mënyrë specifike në *Strategjinë e Ngrohjes*. Thuhet se shfrytëzimi i linjitet të lagësht dhe shfrytëzimi i paqëndrueshëm i drurit për ngrohje duhet të minimizohet. Përdorimi i energjisë diellore, mbeturinave komunale dhe mbetjeve drusore shihen si BRE më premtuese bazuar në opsionet e furnizimit me ngrohje. Megjithatë, është theksuar se teknologjitë e mbeturinave ende janë shumë të shtrenjta për shfrytëzim në shkallë më të madhe. Stimulimet financiare për këto shfrytëzime janë paraparë në *Strategjinë e Ngrohjes*, por ato ende nuk ekzistojnë.

Më 2009 *Dokumenti politik dhe strategjik për zhvillimin e sektorit të pylltarisë 2010-2020* është hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Dokumenti në veçanti trajton viset rurale, ku druri do të vazhdojë të jetë burimi më i rëndësishëm i energjisë për ngrohje. Për këtë arsye, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë (2010-2020), ka të bëjë me mbështetjen e përdorimit të sistemeve dhe metodave që çojnë në shfrytëzim më të mirë të fondit pyjor për prodhim të energjisë.

Korniza legjislative dhe rregullative

Legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme është përmbledhur më poshtë:

LEGJISLACIONI PRIMAR I ENERGISË	
Akt ligjor	Dispozitat kryesore
Ligji Nr.03/L-184 për Energjinë (GZ.Nr.86/15 Nëntor 2010).	Ligji Nr.03/L-184 për Energjinë përcakton se BRE duhet të jenë pjesë përbërëse e Strategjisë për Energjinë, e cila promovon shfrytëzimin optimal të tyre, në pajtim me caqet e miratuara. Për të mbështetur shfrytëzimin e BRE-ve në Kosovë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik harton plane afatgjate dhe afatmesme të veprimit për BRE në pajtim me obligimet e Traktatit të

	<p>Komunitetit të Energjisë. MZhe është, po ashtu përgjegjës për vendosjen e caqeve të BRE-ve, për monitorimin e zbatimit dhe raportimin vjetor për përbushjen e caqeve dhe masave të ndërmarra për këtë qëllim. MZhe miraton legjislacionin sekondar që përfshijnë masa për promovimin e BRE.</p> <p>Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes, sipas nevojës, duhet t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, sipas limiteve të specifikuar në Kodin e Rrjetit. Operatorët e sistemit përcaktojnë dhe publikojnë rregullat lidhur me atë se kush do t'i bartë kostot për adoptimet teknike të nevojshme për integrimin e BRE-ve në sistem. Rregullat duhet të miratohen nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE).</p> <p>ZrRE siguron se tarifat e transmisionit dhe shpërndarjes për prodhuesit e BRE janë jodiskriminuese, posaçërisht ato nga rajonet periferike. ZrRE është, po ashtu organ përgjegjës për lëshimin e certifikatave të origjinës për energjinë e prodhuar nga BRE.</p>
Ligji Nr.3/L-201 për Energjinë Elektrike (GZ. Nr. 86/15 Nëntor 2010)	Ligji Nr.3/L-201 për Energjinë Elektrike përcakton certifikatat e origjinës lëshuar nga ZrRE-ja si organ kompetent për lëshimin e tyre. Furnizuesit publikë të energjisë elektrike janë të obliguar ta blejnë tërë sasinë e energjisë së prodhuar nga BRE nga prodhuesi më tarifë të rregulluar, të caktuar nga ZrRE përmes metodologjisë së përcaktuar, e cila merr parasysh kompensimin nga furnizuesi publik për kostot shtesë të blerjes së energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.
Ligji Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë (GZ. Nr. 86/15 Nëntor 2010).	Ligji Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e ZrRE-së, e cila në fushën e energjisë së ripërtëritshme lëshon certifikatat e origjinës, zhvillon metodologjinë për tarifat e rregulluara dhe lëshon licenca për aktivitetet e energjisë dhe autorizimet për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë.
Ligji Nr.03/L-116 për Ngrohjen Qendrore (GZ. Nr.45/12 Janar 2009)	Ligji Nr.03/L-116 për Ngrohjen Qendrore mundëson ndërmarrjet e ngrohjes, të cilat shfrytëzojnë ngrohje të pashfrytëzuar, apo ngrohje nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, mbeturinat apo bashkëprodhimi, që të marrin certifikatat e origjinës, të cilat lëshohen nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Ngrohja për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës ka përparësi mbi blerjet tjera të ngrohjes nga furnizuesi publik. Bazuar në certifikatat e origjinës, prodhuesi i ngrohjes do të ketë të drejtë të lëshojë dhe shesë certifikata të gjelbra.
LEGJISLACIONI SEKONDAR PËR ENERGIJË	
Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë	Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen caqet afatgjata dhe vjetore të energjisë nga burimet e ripërtëritshme për konsumin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe në transport të prodhuar nga BRE deri në vitin 2020.
Rregulli për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës dhe procedurat për praninë në skemën mbështetëse	Ky rregull përmban dispozita për përcaktimin e nivelit të kapaciteteve të prodhimit të nevojshme për t'i përbushur caqet indikative për konsumin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, kriteret dhe procedurat për praninë në skemën mbështetëse, të drejtat dhe obligimet e prodhuesve të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, për të cilat është lëshuar certifikata e origjinës të pranuar në skemën mbështetëse, të drejtat dhe obligimet e prodhuesve të energjisë elektrike, për të cilët është lëshuar certifikata e origjinës, por që nuk janë të pranuar në skemën mbështetëse, të drejtat dhe obligimet e furnizuesit publik në lidhje me energjinë elektrike, për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës, të drejtat dhe obligimet e OSTT (operatori i pavarur i sistemit të transmisionit dhe tregut), financimi i

	skemës mbështetëse, integrimi i energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në sistemin e energjisë elektrike.
Vendimi _V_359_2011 përcaktohen tarifat nxitëse Feed-in për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë	Vendimi _V_359_2011 përcakton: Tarifat nxitëse Feed-in për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë. Tarifat Feed-in që vlejné për kapacitetet gjeneruese me teknologji të re dhe me pajisje të reja. Burimet primare të energjisë së ripërtëritshme që përdoren në prodhimin e energjisë elektrike të pranuar në Skemën e mbështetjes janë: Uji, era, biogazi dhe biomasa.
Rregulla për krijimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me ngrohje, në një njësi të vetme gjeneruese	Kjo Rregull përcakton dispozitat që kanë të bëjnë me themelimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të menaxhuar nga ZRrE për lëshimin, bartjen, rimarrjen dhe revokimin/anulimin e certifikatave të origjinës me referencë në energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, nga mbeturinat dhe të kombinuar në ngrohje.
LEGJISLACIONI DHE RREGULLTIVAT POLITIKE TË FUSHAVE TJERA	
Fusha e politikës	Aktet kryesore ligjore dhe dispozitat e tyre
Mbrojtja e mjedisit	Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (GZ. Nr.50/06 Prill 2009) dhe Ligji Nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor (GZ.Nr.49/25 Mars 2009), kërkojnë realizimin e vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe vlerësimin strategjik mjedisor për planet, apo programet të cilat me gjasë do të kenë ndikim të konsiderueshëm mjedisor, posaçërisht në sektorin e energjisë dhe minierave, pylltarisë dhe projektet e menaxhimit të ujërave. Sipas Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 79. 1, subjektet private janë të obliguara që t'i shfrytëzojnë resurset e energjisë në mënyrë racionale. Ato të cilat përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë mund të kenë të drejta në ulje, apo lirime nga pagesa e tatimeve, obligimeve doganore dhe të tjera. Zgjidhjeve më të mira të procesit të prodhimit në raport me mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit të energjisë mund t'u jepen çmime. Ligji Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis (GZ. Nr.50/06 Prill 2009), në Shtojcën 1, përcakton projektet e industrisë së energjisë, për të cilët duhet të kryhen vlerësimet e ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (GZ. Nr.52/08 Maj 2009), në Shtojcën 1, përcakton instalimet e industrisë së energjisë, të cilat duhet të ndërmerren aktivitete për kontroll të integruar të ndotjes.
Mbeturinat	Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat (GZ. Nr.17/29 Qershor 2012) përfshin dispozita për mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndotja përmes

parandalimit dhe zvogëlimit të prodhimit të mbeturinave dhe dëmit të tyre përmes shfrytëzimit të mbeturinave si burim i energjisë në mesin e masave tjera.
--

Legjislacioni primar:

Me qëllim të harmonizimit të legjislacionit aktual me dispozitat e pakos së tretë të Direktivave të BE-së për energjinë, MZHE është në proces të hartimit të këtyre projektligjeve me qëllim të futjes së tyre në Programin Legjislativ për vitin 2014:

1. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë.
2. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë.
3. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-201 për Energjinë Elektrike.
4. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-133 për Gazin Natyror.
5. Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-116 për Ngrohje Qendrore.

Korniza institucionale

Politika e përgjithshme e energjisë, në këtë mënyrë edhe politika e BRE-ve, është nën kompetencën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Për zbatimin e politikës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë, MZHE harton planin afatmesëm dhe afatgjatë të veprimit për BRE, caktimin e caqeve vjetore dhe afatgjata të BRE dhe miratimin e legjislacionit sekondar që përmban masat për realizimin e këtyre caqeve. Veç kësaj, ajo është e obliguar që të raportojë në baza vjetore lidhur me përmbushjen e caqeve vjetore dhe afatgjata të BRE-ve.

Një tjetër institucion kyç për mbështetjen e BRE në Kosovë është Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE). Përgjegjësitë e ZrRE-së në lidhje me BRE janë si në vijim: përcakton procedurat dhe lëshon autorizime për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit; është përgjegjëse për caktimin e kushteve dhe kriterëve për lëshimin e licencave për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e energjisë; përcakton tarifën nxitëse Feed-in për blerjen e energjisë së ripërtëritshme dhe është përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të certifikatave të origjinës.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), deri më tani ka qenë kompani publike me integrim vertikal, përgjegjëse për aktivitete të mihjes dhe prodhim, shpërndarje dhe furnizim të energjisë elektrike. Më 2013, sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë është transformuar në një operator që tani menaxhohet nga një kompani private. Operatori i sistemit të transmisionit dhe tregut (KOSTT) është shthurur nga KEK-u më 2006. Përgjegjësitë kryesore të tij janë planifikimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe operimi i sistemit të transmisionit të energjisë elektrike; operimi i tregut të energjisë elektrike dhe promovimi i konkurrencës së tregut; sigurimi i qasjes së hapur. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) dhe Operatori i sistemit të transmisionit (OST) kanë për obligim që të marrin tërë energjinë elektrike të prodhuar nga BRE në rrjetin vendor të energjisë elektrike, t'i japin prioritet prodhuesve të BRE në dispečim, në pajtim me kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit dhe t'u ofrojnë prodhuesve potencialë të BRE kushtet teknike dhe vlerësimet e kostove për lidhje në rrjet.

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit për objekte të prodhimit të energjisë nën 20 MW kapacitet të instaluar. Ato duhet të bashkëpunojnë me MZHE, OST dhe OSSH për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës për objekte të energjisë. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për lëshimin e servitutit, apo të drejtave të tjera pronësore. Në rast të kontesteve ndërmjet autoriteteve lokale dhe kompanive të energjisë që kërkojnë servitut, apo të drejta tjera, vendimi përfundimtar merret nga ZRrE.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit për objektet me kapacitet të instaluar prej më shumë se 20 MW. Ato, gjithashtu lëshojnë koncesione për shfrytëzim të ujit dhe menaxhojnë sistemet e vlerësimeve të ndikimit në mjedis dhe lëshimin e lejeve mjedisore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për politikëbërjen në sektorin e pylltarisë. Ajo parashihet aktivitetet e pylltarisë, siç janë: mbrojtja, pyllëzimi dhe eksploatimi i qëndrueshëm duke përfshirë edhe drurin për djegieje .

Plasimi e biokarburanteve në treg i takon Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), si institucion kompetent për tregun e produkteve të naftës.

Rezultatet dhe konkluzat e deritanishme

Nga informatat e mësipërme, është e qartë se Kosova ka njohur rëndësinë e përdorimit të BRE për zhvillimin e ardhshëm energjetik. Korniza strategjike, ligjore dhe institucionale që shërben si mbështetje për vendimet individuale për investime në prodhimin e energjisë është në fuqi. Kjo kornizë mundëson realizimin e shumë studimeve dhe projekteve demonstruese për të dëshmuar realizueshmërinë e përdorimit të BRE në Kosovë. Përmbledhja e aktiviteteve të kaluara është paraqitur më poshtë.

Lloji i veprimit	Përshkrimi i veprimit
Zhvillimi i HC-ve të mëdha	Si pjesë e Projektit të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti (PATEL), Banka Botërore (BB) ka financuar shqyrtimin e studimit ekzistues të realizueshmërisë së HC Zhur. Në përputhje me politikat e BB, është realizuar, po ashtu studimi i vlerësimit paraprak për ndikimet mjedisore dhe sociale. Sipas këtyre studimeve, HC Zhur është i realizueshëm dhe në gjendje t'i ofrojë sistemit të energjisë elektrike të Kosovës kapacitete të prodhimit prej 305 MW, në prodhim vjetor mesatar prej 398 GWh.
HC-të e reja të vogla	Gjatë vitit 2006, 2009 dhe 2010, MZHE (ish-MEM), ka kryer studime të vlerësimeve paraprake për potencialin e vendit për HC të vogla. Zhvillimi i HC-ve të vogla pritet të bëhet përmes investimeve kapitale private. Potencialet janë vlerësuar të jenë rreth 130 MW të kapaciteteve të reja të instaluar me prodhim mesatar vjetor prej 621 GWh.
Revitalizimi i HC-ve ekzistuese	Katër HC operojnë si pjesë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK): HC Dikanc, HC Lumbardhi, HC Radavci dhe HC Burimi. Këto HC janë rehabilituar gjatë viteve 2009-2010 dhe kanë rritur prodhimin e tyre. HC Lumbardhi është rehabilituar dhe komisionuar më 2005 nga një kompani, e cila e ka marrë atë me qira për një periudhë prej 20+20 vite. Kapaciteti i instaluar i këtij HC është 8.08 MW. HC Dikanc është dhënë me qira dhe është funksionalizuar më 2010, ndërsa kapacitetet e instaluar të tij janë

	rritur në 1 MW gjatë riparimit të tij. HC Radavci është rehabilituar më 2010 nga kompania që e ka marrë atë me qira. Kapacitetet e instaluara të këtij HC, po ashtu janë rritur nga 0.35 MW në 0.9 MW. HC Burimi është dhënë me qira dhe kapacitetet e tij janë rritur nga 0.56 MW në 0.86 MW. HC Ujmani, po ashtu kontribuon në sistemin elektrik të Kosovës me kapacitete të instaluara prej 35MW dhe prodhim vjetor prej rreth 88 GWh (më 2010). Ky HC është në pronësi të Hidrosistemit Ibër-Lepenc. ¹
Vlerësimi i potencialeve tjera të BRE	Më 2008 janë vlerësuar potencialet për energjinë diellore, erën, biomasën dhe energjinë gjeotermale, me ndihmën e shërbimeve konsulente të kompanisë daneze COWI.
Instalimi i turbinave me erë	Më 2009 janë instaluar kapacitetet e para të energjisë nga era me kapacitet prej 3 x 0.45 MW në kodrën e Goleshit në afërsi të Prishtinës. Më 2010 janë dorëzuar në ZRrE katër kërkesa tjera nga kompani private në Artanë, Dardanë dhe Shtime. Gjatë vitit 2013 në ZRrE janë dorëzuar tri aplikacione për lokacionet në Rahovec (Zatriq), Suharekë (Budakovë), dhe Drenas. ²
Ngrohja diellore e ujit	Kolektorët solarë janë instaluar në një varg objektesh në Qendrën e Klinike Universitare të Kosovës dhe në Qendrën Studentore në Prishtinë, me financim të buxhetit shtetëror (gjatë vitit 2008-2009), dhe në tri objekte tjera publike – pjesë e projektit për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë, me financim të Komisionit Evropian (gjatë vitit 2010).

Kosova është në rrugë të duhur drejt rritjes së konsiderueshme të shfrytëzimit të BRE. Ky Plan Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (PKVBRE) me caqe të caktuara dhe masa që duhet ndërmarrë për përmbushjen e tyre deri më 2020 paraqet politikën gjithëpërfshirëse të Qeverisë për nxitjen e shfrytëzimit të BRE në Kosovë.

PKVBRE është përgatitur bazuar në modelin e përpiluar nga Komisioni Evropian (KE) dhe i paraqitur në Vendimin e Komisionit 2009/584/EC. Ai përmbush të gjitha kërkesat e Direktivës 2009/28/EC të adaptuara sipas Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC dhe ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

MZhE është përgjegjëse për hartimin e PKVBRE sipas caqeve afatgjate për BRE të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë deri më 2020 për shfrytëzimin e BRE për konsumin e energjisë elektrike, ngrohje dhe transport.

Institucionet tjera të angazhuara që në mënyrë aktive kanë kontribuar në PKVBRE me informata lidhur me fushën e tyre të përgjegjësisë janë:

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE), me përshkrimin e procedurave të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë, sistemin e tarifave për blerjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe sistemin e certifikatave të origjinës;

¹ Reference: KOSST; ZRrE; Balanca Afatgjate e Energjisë (2013-2022) (MZhE)

² ZRrE

- Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), me përshkrimin e zhvillimit të infrastrukturës së energjisë elektrike dhe operimit të rrjetit të energjisë elektrike;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), me përshkrimin e përdorimit të energjisë nga BRE në sektorin e ndërtesave;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), me përshkrimin e kornizës rregullative për biokarburante (dhe biolëngje të tjera), dhe skemës mbështetëse për promovimin e përdorimit të biokarburantëve në transport;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) me përshkrimin nga fusha e përdorimit të energjisë nga biomasa;
- Ministria e Financave (MF), me miratimin e masave fiskale.

2. PARASHIKIMI I KONSUMIT FINAL TË ENERGJISË 2010-2020

Bruto konsumi final i parashikuar i energjisë në periudhën deri më 2020 është paraqitur në Tabelën 1, dhe bazuar në dokumentin e titulluar *Parashikimi i Kërkesës për Energji, që mbulon periudhën 2013-2022*. Të dhënat e paraqitura në këtë dokument paraqesin konsumin final të energjisë, që duhej rishikuar për të qenë në përputhshmëri me përkufizimin e bruto konsumit final të energjisë sipas Direktivës 2009/28/EC. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar të dhënat lidhur me konsumin e energjisë elektrike të ofruara nga OST.

Tabela 1, përmban dy skenarë për bruto konsumin final të energjisë: ‘skenari bazë’ dhe ‘skenari me efikasitet të energjisë’. Figura 1, paraqet dallimin ndërmjet dy skenarëve. Dallimi ndërmjet këtyre dy skenarëve në vitin 2018 përmban shumën e parashikuar të kursimeve të energjisë të paraqitura në Planin e Kosovës të Veprimit për Efikasitet të Energjisë, në përputhje me Direktivën 2006/32/EC për efikasitetin e energjisë të përdoruesit fundorë dhe shërbimet e energjisë, që është 130 ktoe. Rritja e mëtejme e konsumit të energjisë në të dy skenarët supozohet të jetë e njëjtë me rritjen e arritur në periudhën 2017-2018. Shkalla mesatare e rritjes vjetore të konsumit të energjisë në skenarin bazë, në periudhën 2010-2020 është 3.88%, ndërsa në skenarin e efikasitetit të energjisë është 2.89%.

Trajtimi i pjesëve të tjera të PKVBRE bazohet në skenarin me efikasitet të energjisë.




Figura 1 – Bruto konsumi final i parashikuar i energjisë në skenarin bazë dhe atë me efikasitet të energjisë deri më 2020

Në të dy skenarët, dallimi bëhet sipas shfrytëzimit të tri formave të energjisë: energjia elektrike, ngrohjes dhe ftohjes dhe transporti. Duhet të theksohet, megjithatë se energjia elektrike e shfrytëzuar për qëllime të ngrohjes dhe ftohjes është në kuadër të shfrytëzimit të energjisë elektrike, ndërsa ngrohja dhe ftohja i referohet vetëm ngrohjes së shitur nga sistemet e ngrohjes qendrore dhe përmbajtjes së energjisë së lëndëve tjera djegëse (druri, linjiti, gazi i lëngëzuar naftë dhe produktet tjera të naftës), të përdorura nga konsumatorët fundorë të energjisë.

Pjesa e Tabelës 1, që ka të bëjë me konsumin e energjisë në transportin ajror e vendosur në model (shabllon) nuk është plotësuar, meqë bruto konsumi final i energjisë në këtë nënsektor nuk tejkalon 6.18 %.

Siç shihet nga Tabela 1, bruto konsumi final i parashikuar i energjisë më 2020 është 1.729,82 ktoe dhe do të shfrytëzohet më tutje në këtë PKVBRE për kalkulimin e caktit të përgjithshëm, caqeve nënsektoriale dhe trajektoreve.

Tabela 1–Bruto konsumi final i parashikuar i energjisë në Kosovë për ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport deri më 2020 duke marrë parasysh efektet e eficiencës së energjisë dhe masat e kursimit të energjisë³2010-2020 (ktoe)

	2009	2010		2011		2012		2013		2014	
	viti bazë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë
(1) ngrohje dhe ftohje ⁴	486,48		497,36		550,36		526,04	564,13	547,70	584,92	562,43
(2) energji elektrike ⁵	455,23		470,97		528,16		533,07	557,78	541,53	590,82	568,10
(3) transport sipas nenit 3(4)a ⁶	327,35		304,67		313,32		311,58	328,75	319,17	340,58	327,48
(4) Bruto Konsumi final i energjisë ⁷	1301,10		1300,65		1426,12		1407,11	1.462,78	1420,17	1540,68	1481,42
<i>Kalkulimi në vijim është i nevojshëm vetëm nëse bruto konsumi final i energjisë për avionin pritet të jetë më i lartë se 6,18%</i>											
Konsumi final në aviacion											
Ulje për limitin e avionit ⁸ neni 5(6)											
Gjithsej konsumi pas uljes për kufizimin e avionit											

³ Këto vlerësime për eficiencën e energjisë dhe kursimeve të energjisë janë në pajtim me vlerësimet tjera që Palët Kontraktuese paraqesin në Planin e Veprimit në kuadër të Direktivës për Shërbime të Energjisë dhe Direktivën për Performancën energjetike të ndërtesave. Nëse shfrytëzohen njësi tjera në ato Plane të Veprimit, faktorët e konvertimit që aplikohen duhet të cekën.

⁴ Është konsumi final i energjisë i të gjitha elementeve të energjisë përveç energjisë elektrike për qëllime të tjera përveç transportit, plus konsumi i ngrohjes për përdorim vetanak në central dhe humbjet e ngrohjes në rrjete (pikat '2. Përdorimi vetanak nga centrali 'dhe '11. Humbjet në transmision dhe shpërndarje në faqen 23 dhe 24 të Rregullores së Statistikave të energjisë, OJ L304 of 14.11.2008) .

⁵ Bruto Konsumi i energjisë elektrike është prodhimi bruto vendor i energjisë elektrike, duke përfshirë prodhimi vetanak, plus importet minus eksportet.

⁶ Konsumi i transportit sipas definicionit të nenit 3(4)a të Direktivës 2009/28/EC. Energjia e ripërtëritshme në transportin rrugor për këtë shifër duhet të shumëzohet me faktorin 2,5, e cekur në nenin 3(4)c të Direktivës 2009/28/EC.

⁷ E definuar në nenin (2)f të Direktivës 2009/28/EC. Kjo përbëhet nga konsumi final i energjisë plus humbjet në rrjet dhe përdorimi vetanak i ngrohjes dhe energjisë elektrike dhe centraleve të ngrohjes (NB: kjo nuk përfshin konsumin e energjisë elektrike për pompimin e rezervës së ujit, apo për transformim në bojlerë elektrikë, apo pompave termike në centrale të ngrohjes).

⁸ Sipas nenit 5(6) konsumi për aviacion duhet të konsiderohet vetëm deri në 6.18% të konsumit bruto final.

	2015		2016		2017		2018		2019		2020	
	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë	skenari bazë	skenari me eficiencë të energjisë
(1)ngrohje-ftohje ⁹	609,18	580,17	631,25	595,52	649,39	606,90	672,05	622,27	694,78	637,41	718,65	653,32
(2) energji elektrike ¹⁰	616,19	586,84	634,81	598,88	658,19	615,13	677,90	627,69	729,17	668,96	751,37	683,06
(3) transport sipas nenit 3(4)a ¹¹	352,45	335,66	362,76	342,23	369,17	345,02	379,36	351,26	389,50	357,34	399,65	363,32
(4) bruto konsumi final i energjisë ¹²	1599,54	1523,37	1651,08	1557,63	1704,19	1592,70	1758,18	1627,95	1844,20	1691,93	1902,81	1729,82 ¹³
<i>Kalkulimi në vijim është i nevojshëm vetëm nëse konsumi final i energjisë për aviacionin pritet të jetë më i lartë se 6,18% (4,12% për Maltën dhe Qipron):</i>												
Konsumi final në aviacion												
Ulje për limitin e aviacionit ¹⁴ Art. 5(6)												
Gjithsej konsumi pas uljes për kufizimin e aviacionit												

⁹ Shih fusnotën 4

¹⁰ Shih fusnotën 5

¹¹ Shih fusnotën 6

¹² Shih fusnotën 7

¹³ Konsumi bruto final i energjisë është vlerësim i bazuar në Balancën Afatgjate të Energjisë (2013-2022) (MZhE)

¹⁴ Shih fusnotën 8

3. CAQET DHE TRAJEKTORJA E ENERGJISË NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME

3.1. Caku i përgjithshëm

Caku i përgjithshëm i obligueshëm shtetëror për pjesëmarrjen e energjisë nga BRE në bruto konsumin final të energjisë në vitin 2020 është 25%, i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC dhe ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Megjithatë, Kosova do të synojë një cak më të lartë që korrespondon me 29.47% të bruto konsumit final të energjisë më 2020.

Për shkak të kohës së kufizuar për realizimin e caqeve, mungesës së përgatitjes së projekteve të përbashkëta dhe mungesës së përvojës në çështjet që kanë të bëjnë me transferimet statistikore dhe skemave të përbashkëta mbështetëse, Kosova nuk do të shfrytëzojë, së paku në kohën aktuale, mekanizmat e fleksibilitetit të cekur në nenet 6 deri 11 të Direktivës 2009/28/EC dhe nenet 8 dhe 9 të Vendimit të cekur më sipër të Këshillit të Ministrave. Megjithatë, ndryshimet në legjislacionin ekzistues, posaçërisht në Ligjin Nr.03/L-184 për Energjinë, të cilat parashihen të miratohen deri në fund të vitit 2014, cekin se përdorimi i mekanizmave fleksibilë do të mundësohet sipas rregullave të përshkruara nga Qeveria.

Meqë Kosova planifikon ta arrijë dhe tejkalojë cakun e saj të obligueshëm shtetëror përmes masave shtetërore për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, ekziston potencial për transferimin e shumave të tepërta mbi trajektoren indikative përmes mekanizmave të ndryshëm fleksibil për bashkëpunim, por aktualisht kjo nuk është planifikuar. Në anën tjetër, nëse raporti i rregullt për zbatimin e këtij PKVBRE dhe përparimi në përmbushjen e caqeve sugjeron që Kosova nuk është në gjendje t'i arrijë caqet e obligueshme vetëm përmes prodhimit vendor, do të ndërmerren hapa adekuatë për t'i hulumtuar mundësitë për përdorimin e këtyre mekanizmave.

Tabela 2–Caku i përgjithshëm shtetëror për pjesëmarrjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë në vitin 2009 dhe 2020

A. Pjesëmarrja e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë më 2009 (S_{2009}) (%)	18,90	18,90
B. Caku i energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin final të energjisë më 2020 (S_{2020}) (%)	25,00	29,47
	(i obligueshëm)	(vullnetar)
C. Totali i konsumit final të parashikuar të energjisë më 2020 (nga Tabela 1, qelia e fundit) (ktoe)	1729,82	1729,82
D. Shuma e parashikuar e energjisë nga burimet e ripërtëritshme që korrespondon me cakun 2020 (kalkuluar si B x C) (ktoe)	432,46	509,70

3.2. Caqet indikative sektoriale

PKVBRE përcakton caqet e energjisë nga BRE për tre sektorë: energji elektrike, transport dhe ngrohje e ftohje (Tabela 3).

- 25.64% të BRE në bruto konsumin final të energjisë elektrike;
- 10 % të BRE në bruto konsumin final në transport;
- 45.65 % të BRE në bruto konsumin final për ngrohje dhe ftohje.

Mënyra e plotësimit të caqeve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, deri në vitin 2020

Për plotësimin e Caqeve vjetore të energjisë nga BRE është parashikuar ndërtimi i kapaciteteve të reja të energjisë nga teknologji të ndryshme të BRE në tre sektorë: energji elektrike; energji termike për qëllime ngrohjeje e ftohjeje dhe në transport. Ndërsa, për plotësimin e caktuar të energjisë nga BRE, në vitin 2020 janë parashikuar kapacitetet e reja prodhuese, si në vijim:

- 25.64% të BRE në bruto konsumin final të energjisë elektrike do të plotësohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese si në vijim:

Në sektorin e energjisë elektrike, rritja e prodhimit të BRE bazohet në ndërtimin e kapaciteteve të vogla dhe të mëdha të ujit: 240MW nga hidrocentralet e vogla; 305MW nga HC Zhuri, 150MW nga era, 14MW nga biomasë, dhe në një shkallë më të vogël instalimet fotovoltaike prej 10MW. Sektori i energjisë elektrike kontribuon në cakun e përgjithshëm të BRE me 10.1 %.

- 10 % të BRE në bruto konsumin final në transport do të plotësohet përmes shfrytëzimit të biokarburanteve, siç do të përcaktohet me UA për përdorimin e biokarburanteve në transport.

Caku sektorial për BRE në transport, i kalkuluar në pajtim me nenin 3(4) të Direktivës 2009/28/EC, është 10%. Por, pjesa aktuale në konsumin e përgjithshëm të energjisë në transport (e cila është më e lartë se shumica e llogaritur sipas nenit 3 (4), për shkak të konsumit të kerozinës, lëndës djegëse për avionë, naftës në transport), është në nivel prej 9.24%. Kontributi i këtij sektori në cakun e përgjithshëm është 2.1%.

- 45.65 % të BRE në bruto konsumin final për ngrohje dhe ftohje do të plotësohet përmes ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese si në vijim:

Energji solare nga 70MW_{th}, 10 MW_{th} nga pompat termike. Sektori i ngrohjes dhe ftohjes merr pjesë në cakun e përgjithshëm të BRE me 17.2 % në vitin 2020. Pjesëmarrja kryesore është nga shfrytëzimi i biomasës në formë të drurit tradicional si lëndë djegëse, që do të vazhdojë të jetë burimi më i rëndësishëm për ngrohje në Kosovë.

Kosova planifikon të përmbushë cakun e përgjithshëm me burime të brendshme; prandaj shfrytëzimi i mekanizmave të bashkëpunimit nuk është paraparë.

Tabela 3–Caku shtetëror për vitin 2020 dhe trajektorja e parashikuar e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport

Si Pjesa B e Shtojcës I të Direktivës

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
BRE-N&F ¹⁵ (%)	48.37%	47.64%	44.07%	46.45%	45.22%	44.91%	44.77%	44.84%	45.24%	45.37%	45.53%	45.65%
BRE-E ¹⁶ (%)	2.26%	2.85%	1.71%	2.16%	2.12%	5.13%	5.62%	6.58%	13.20%	14.42%	14.10%	14.33%*
	2.26%	2.85%	1.71%	2.16%	2.12%	7.34%	13.78%	15.00%	21.60%	23.18%	23.39%	25,64%**
BRE-T ¹⁷ (%)	0,03%	0,02%	0,04%	0,00%	0,00%	1,00%	2,00%	3,00%	4,00%	6,00%	8,00%	10,00%
Pjesa totale e BRE¹⁸ (%)	18.90%	19.26%	17.65%	18.18%	18.25%	19.29%	19.66%	20.33%	23.20%	24.20%	24.42%	25.00%*
	18.90%	19.26%	17.65%	18.18%	18.25%	20.14%	22.80%	23.57%	26.45%	27.58%	28.09%	29.47%**
<i>Nga e cila prej mekanizmave të bashkëpunimit¹⁹</i>												
<i>Teprica për mekanizmat e bashkëpunimit¹⁷</i>												
						2011-2012	2013-2014	2015-2016	2017-2018			2020
						S2009 +20% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S2009 +30% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S2009 +45% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)	S2009 +65% (S ₂₀₂₀ -S ₂₀₀₉)			S ₂₀₂₀
BRE trajektorja minimale (%)						20.12	20.73	21.65	22.87			25
BRE trajektorja minimale (ktoe)						348.04	358.59	374.42	395.52			432.46

*) Caqet e BRE në pajtim me Vendimin e KM nr. 2/2012/04 të datës 18 tetor 2012

***) Caqet e BRE bazuar në UA për caqet e BRE nr.01/2013

¹⁵ Pjesëmarrja e energjisë nga BRE në ngrohje dhe ftohje: konsumi final bruto i energjisë nga burimet e ripërtëritshme për ngrohje dhe ftohje (definuar në nenet 5(1)b) dhe 5(4) të Direktivës 2009/28/EC pjesëtuar me konsumin bruto final të energjisë për ngrohje dhe ftohje. Linja (A) nga tabela 4a pjesëtuar me linjën (1) të tabelës 1.

¹⁶ Pjesëmarrja e energjisë nga BRE në energjinë elektrike: konsumi final bruto i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme për energji elektrike (definuar në nenin 5(1)a) dhe 5(3) të Direktivës 2009/28/EC pjesëtuar me konsumin bruto final të energjisë elektrike. Rreshti (B) nga Tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (2) të Tabelës 1.

¹⁷ Pjesëmarrja e energjisë së ripërtëritshme në transport: energjia finale nga burimet e ripërtëritshme të konsumuar në transport (cf. Neni (1)c) dhe 5(5) i Direktivës 2009/28/EC pjesëtuar me konsumin në transport të 1) naftës; 2) dizelit; 3) biokarburantëve të përdorur në transportin rrugor dhe hekurudhor dhe 4) energjia elektrike në transportin tokësor (sipas rreshtit 3 të Tabelën 1). Linja (J) nga Tabela 4b pjesëtuar me rreshtin (3) të Tabelës 1.

¹⁸ Pjesëmarrja e energjisë së ripërtëritshme në konsumin bruto final të energjisë. Rreshti (G) nga Tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (4) të Tabelës 1.

¹⁹ Në pikë të përqindjes totali i pjesëmarrjes së BRE

Trajektorja e realizimit të BRE është më e vogël se trajektorja minimale e BRE për përmbushjen e caqeve të obligueshme të definuara në modelin e PKVBRE, ku viti bazë është 2009, në vend të 2005. Kjo duket se është si pasojë e fillimit të vonshëm të PKVBRE të Kosovës dhe vetëm për periudhën deri në vitin 2015, prandaj nuk është relevante.

Tabela 4a - 2020 Tabela e kalkulimeve për pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë të secilit sektor në konsumin final të energjisë (ktoe)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
(A) Bruto konsumi i parashikuar i energjisë për ngrohje dhe ftohje nga BRE	235.30	236.96	242.56	244.34	247.68	253.32	259.74	267.06	274.55	282.32	290.21	298.24
(B) Bruto konsumi i parashikuar i energjisë elektrike nga BRE	10.30 10.30	13.42 13.42	9.02 9.02	11.53 11.53	11.49 11.49	29.12 41.72	32.99 80.84	39.41 89.82	81.17 132.84	90.49 145.51	94.36 156.45	97.89* 175.13**
(C) Bruto konsumi i parashikuar i energjisë nga BRE në transport	0.10	0.07	0.13	0.00	0.00	3.27	6.71	10.27	13.80	21.08	28.59	36.33
(D) Totali i bruto konsumit final të parashikuar të energjisë nga BRE ²⁰	245.70 245.70	250.45 250.45	251.71 251.71	255.87 255.87	259.17 259.17	285.71 298.32	299.44 347.29	316.73 367.14	369.52 421.19	393.88 448.91	413.16 475.25	432.46* 509.70**
(E) Transferimi i parashikuar i energjisë nga BRE te shtetet tjera anëtare	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
(F) Transferimi i parashikuar i energjisë nga BRE nga shtetet tjera anëtare dhe shtetet e treta	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

²⁰ Sipas nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC gazi, energjia elektrike dhe hidrogjeni nga burimet e ripërtëritshme të energjisë merret parasysh vetëm njëherë. Nuk lejohet numërimi i dyfishtë.

(G) Konsumi i parashikuar i energjisë nga BRE, i përshtatur për cakun (D) - (E) + (F)	245.70	250.45	251.71	255.87	259.17	285.71	299.44	316.73	369.52	393.88	413.16	432.46*
	245.70	250.45	251.71	255.87	259.17	298.32	347.29	367.14	421.19	448.91	475.25	509.70**

*) Caqet e BRE në pajtim me Vendimin e KM nr. 2/2012/04 të datës 18 tetor 2012

***) Caqet e BRE bazuar në UA për caqet e BRE nr.01/2013

Tabela 4b - 2020 Tabela e kalkulimit për pjesëmarrjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në transport (ktoe)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
(C) Konsumi i parashikuar i energjisë nga BRE në transport ²¹	0,10	0,07	0,13	0,00	0,00	3,27	6,71	10,27	13,80	21,08	28,59	36,33 ²²
(H) Energjia elektrike e parashikuar i energjisë nga BRE në transportin rrugor ²³	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
(I) Konsumi i parashikuar i biokarburanteve nga mbeturinat, mbetjet, materialet joushqimore celulozike dhe lingo-celulozike në transport ²⁴	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
(J) Pjesëmarrja e parashikuar e energjisë nga BRE në transport	0,10	0,07	0,13	0,00	0,00 ²⁵	3,27	6,71	10,27	13,80	21,08	28,59	36,33

²¹ Që përmban të gjitha BRE të përdorura në transport duke përfshirë energjinë elektrike, hidrogjenin dhe gazin nga BRE, dhe përjashtuar biokarburantet që nuk përputhen me kriteret e qëndrueshmërisë (cf. Neni 5(1) nënparagrafi i fundit). Saktëso këtu vlerat reale pa përdorur faktorë shumëzimi.

²² Balanca Afatgjate e Energjisë (2013-2022) (MZhE)

²³ Saktëso këtu vlerat reale pa përdorur faktorë shumëzimi.

²⁴ Saktëso këtu vlerat reale pa përdorur faktorë shumëzimi.

²⁵ Reference: Balanca Afatgjate e Energjisë (2013-2022) (MZhE)

për pjesën e BRE-T: (C)+(2,5-1)x(H)+(2-1)x(I)													
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

4. MASAT PËR ARRITJEN E CAQEVE

4.1. Pasqyrë e politikave dhe masave për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme

Masat ekzistuese janë paraqitur në tabelën 5, ndërsa ato të planifikuara janë paraqitur në tabelën 6, të ndara sipas produktit energjetik: energji elektrike, ngrohje e ftohje, transport si dhe masa ndërsektoriale.

Veprimi (emri dhe referenca e masës)	Lloji i masës *	Indikatorët e suksesit (rezultati i pritur **)	Grupi i cakut dhe/apo aktiviteti ***	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Data e fillimit dhe përfundimit të masës
ENERGJIA ELEKTRIKE						
<p>1. Skema mbështetëse për energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-Feed-in tarifa (erë, biomasë, ujë)</p> <p>Rregulli për mbështetjen e energjisë elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës dhe procedurat e pranimit në skemën mbështetëse</p>	Rregullative Financiare	Rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE	Investues, Instalues	ZRRë	_____	2011
2. Certifikata e origjinës Rregulli për themelimin e një sistemi të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, nga mbeturinat dhe	Rregullative	Transparenca e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE	Prodhuesit e energjisë dhe përdoruesit e energjisë	ZRRë	_____	2010

bashkëprodhimi në kombinim me ngrohjen në një njësi të vetme të prodhimit						
3. Studim i parafizibiliteti për identifikimin e potencialeve hidroenergjetike për ndërtim të hidrocentraleve të vogla (HCV) në Kosovë	Studimi vlerësimi	Identifikimi i mundësive për ndërtimin e 63 MW në HCV	Investues në HCV	MZhE	50,000.00 DANIDA	Maj 2006
4. Vlerësim i mëtejme i hidropotencialeve të energjisë për HCV në Kosovë	Studimi vlerësimi	Identifikim shtesë i lokacioneve të reja për HCV prej 22 MW	Investues në HCV	MZhE		Nëntor – Dhjetor 2009
5. Vlerësim i mëtejme i hidropotencialeve të energjisë për HCV në Kosovë	Studimi vlerësimi	Identifikim shtesë i lokacioneve të reja për HCV prej 50 MW	Investues në HCV	E finalizuar		Mars- Korrik 2010
6. Hartimi i pakos tenderuese për ndërtimin e HCV në Kosovë	Rregullative	Përshpejtimi i përmbylljes së dokumentacionit të nevojshëm për procedurat e tenderimit për ndërtimin e HCV	Mbështetje për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe investuesit	E finalizuar	50,000.00 BRK	Maj-Tetor 2008

NGROHJE DHE FTOHJE						
1. Studimi për përgatitjen e të dhënave projektuese për sistemet e shfrytëzimit të energjisë diellore në Kosovë	Studim	Krijimi i bazës së të dhënave për nevoja të parashikimit për shfrytëzim të energjisë solare	Investitorët dhe institucionet relevante për sferën e energjisë	MZhE	60,000.00 BRK	Dhjetor 2010
NDËRSEKTORIALE						
1. Programi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë	Promovuese	Nxitje e përdorimit më të madh të energjisë nga BRE, përmes pilot-projekteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit	Institucione publike, konsumatorë, investues	MZhE	—	2007
2. Fushatë për ndërgjegjësim publik për efiçencën e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë	Fushatë informuese	Informata publike, nxitje e interesimit në përdorimin e BRE	Opinion i publik	Komisioni Evropian	300,000.00	2009/2010

Tabela 5- pasqyra e të gjitha politikave dhe masave ekzistuese

Veprimi (emri dhe referenca e masës)	Lloji i masës *	Indikatorët e suksesit (rezultati i pritur **)	Grupi i caktuar dhe/apo aktiviteti ***	Institucioni përgjegjës	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Data e fillimit dhe përfundimit të masës
ENERGJIA ELEKTRIKE						
1. Skema mbështetëse për energjinë elektrike të prodhuar nga sistemet e vogla solare (SFIN të fotovoltaike të integruara në ndërtesa) Vendimi për tarifën feed-in për energjinë fotovoltaike	Rregullative Financiare	Rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE, Rritje e interesit publik në investimet në BRE	Investues, Instalues	ZRrE	(e pavlerësuar) Konsumatori	nga 2014–
2. Procedura të thjeshtësuara për projekte të BRE	Rregullative	Rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga projektet e vogla të BRE-së	Investues, Instalues	ZRrE	_____	nga 2014 –
NGROHJE DHE FTOHJE						

1. Promovimi i përdorimit të energjisë nga BRE-të për ngrohje/ftohje (grante investuese/pagesë për kapacitete)	Financiare	Rritje e prodhimit të energjisë termike nga burimet e ripërtëritshme (solare, biomasë, gjeotermale) dhe NQ përmes përdorimit të BRE	Investues Instalues	ZRrE	(e pavlerësuar) Konsumatori	2014 -
2. Kuotat e obligueshme për furnizuesin e ngrohjes qendrore për pjesën e energjisë nga BRE në këtë furnizim	Rregullative, Financiare	Rritja e përdorimit të energjisë së ngrohjes nga BRE përmes ngrohjes qendrore	Furnizuesi i ngrohjes qendrore	MZhE	(e pavlerësuar) Konsumatori	2016 -
3. Bonus FIT për përdorimin e ngrohjes nga BP me BRE	Rregullative Financiare	Rritja e përdorimit të energjisë së ngrohjes nga BRE me BP	Investues Instalues	ZRrE	(e pavlerësuar) Konsumatori	2016 -
4. Inkurajimi i bashkëpunimit të grupeve të interesit për të siguruar shfrytëzim më të madh të biomasës, energjisë solare-termike dhe gjeotermike	Promovuese	Krijimi i grupeve të interesit që merren me të gjitha aspektet e realizimit të projektit të energjisë së ngrohjes nga BRE	Prodhuesit e peletit, bykut të drurit, prodhuesit e pajisjeve, instaluesit, arkitektët, ofruesit e ESCO, institucionet financuese, investitorët	MZhE	_____	2015
5. Kërkesat minimale të BRE në ndërtesa	Rregullative	Rritja e përdorimit të BRE në ndërtesat e	Investues	MMPH	_____	2018

UA për përdorimin e BRE në ndërtesa		reja dhe ndërtesat e renovuara me ndërhyrje të mëdha	Instalues			
6. Standard më i lartë i përdorimit të BRE në ndërtesat publike	Promovuese	Rritja e përdorimit të BRE në ndërtesat e reja dhe ndërtesat në renovime madhore, promovim i BRE	Autoritetet publike Publike	MMPH		2014 -
BIOKARBURANTET DHE BIOLËNGJET E TJERA						
1. Përdorimi i biokarburanteve Udhëzimi administrativ për përdorimin e biokarburanteve	Rregullative	10% sasi e biokarburanteve në gjithsej lëndët djegëse më 2020	Distributorët, prodhuesit e biokarburanteve	MTI	_____	2014 -
2. Lirim nga akciza për biokarburante	Fiskale	Rritje e konsumit të biokarburanteve	Konsumatorë	MTI	(e pavlerësuar)	2014 -
3. Pjesa e energjisë nga BRE në transportin publik	Rregullative, promovuese	Pjesëmarrje më e lartë e energjisë nga BRE në transportin publik	Transporti publik	MTI	_____	2014 -
NDËRSEKTORIALE						

1. Lirimi ose ulja e taksës doganore për pajisjet e teknologjive të energjisë nga BRE	Fiskale	Ulje e shpenzimeve kapitale për projektet e BRE	Investitorët	MF	(e pavlerësuar)	2015. -
2. Krijimi i linjave kreditore, apo lirimi nga tatimi në fitim për investimet në fushën e BRE	Fiskale	Përfitimi më i madh i projekteve të BRE, tërheqja e investimeve	Investitorët	MF	(e pavlerësuar)	2015 -
3. Themelimi i zyrave komunale për energji	Rregullative	Themelimi dhe funksionalizimi i zyrave komunale për energji me qëllim të mbështetjes së komunave dhe zhvillimit të projekteve të BRE	Autoritetet qendrore dhe komunale, dhe palët tjera të interesit (investuesit)	MZhE	_____	2015
4. Fushatë promovuese për BRE	Fushatë informimi	Nxitje e interesimit publik për përdorimin e BRE	Konsumatorë, prodhues, publiku	MZhE	150 000.00	2012 - 2014 KASH
5. Programe të kredive të buta për financimin e projekteve të energjisë nga BRE	Financiare	Tërheqje e investimeve	Investitorët	MF	_____	2015-2020

Tabela 6–Pasqyrë e politikave dhe e masave të planifikuara

* tregoni nëse masa është (kryesisht) rregullative, financiare, apo e butë (d.m.th. fushatë informimi).

** a është rezultati i pritur ndryshim në sjellje, kapacitet të instaluar (MW; t/vit), energji të prodhuar (ktoe)?

*** kush janë personat e caktuar: investitorët, përdoruesit fundorë, administrata publike, planifikuesit, arkitektët, instaluesit, etj., apo cili është aktiviteti /sektori i caktuar: prodhimi i biokarburanteve, përdorimi energjetik i plehrave shtazore etj.)?

4.2. Masat specifike për t'i përmbushur kërkesat sipas neneve 13, 14, 16 dhe neneve 17 deri 21 të Direktivës 2009/28/EC

4.2.1. Procedurat administrative dhe planifikimi hapësinor (neni 13(1) i Direktivës 2009/28/EC)

(a) Legjislacioni ekzistues lidhur me procedurat e autorizimit, certifikimit, licencimit dhe planifikimit hapësinor që aplikohet për centrale dhe infrastrukturën përkatëse të rrjetit të transmisionit dhe shpërndarjes është si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë (GZ/ Nr.86/15 nëntor 2010);
- Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë (GZ/Nr.86/15 nëntor 2010);
- Ligji nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike (GZ/Nr.86/15 nëntor 2010);
- Udhëzimi Administrativ nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Rregulla për Procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, e miratuar më 29.08.2011;
- Rregullat për Krijimin e Sistemit të Certifikatave të Origjinës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Ripërtëritshme të energjisë, e miratuar më 29.12.2010;
- Rregulla për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës dhe procedurat e pranimit në skemën mbështetëse, miratuar më 29.12.2010;
- Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, miratuar më 29.08.2011;
- Rregulla për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut (Rregulli për vendosjen e çmimeve OST/OT);
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (GZ/Nr.10/29 prill 2013);
- Ligji Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (GZ Nr.35/17 dhjetor 2012);
- Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim (GZ/Nr.18/03 korrik 2013);
- Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (GZ/Nr,83 29 tetor 2010);
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (GZ/Nr.06 prill 2009);
- Ligji Nr.2004/29 për Pyjet e Kosovës (GZ/Nr.34; 01 gusht 2008);
- Ligji Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (GZ/Nr.52 08 maj 2009);
- Udhëzimi Administrativ Nr. 25/2012 për Lejen Mjedisore;
- Kodi i Rrjetit;
- Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e transmisionit / KOSTT;

- Metodologjia e taksave të kyçjes në rrjetin e shpërndarjes / KEK;
- Rregullat teknike për kyçje.

(b) Institucionet Përgjegjëse dhe kompetencat e tyre në këtë fushë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZhE)

MZhE është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që nxisin rritjen ekonomike dhe bashkëpunimin, zhvillimin e biznesit dhe që sigurojnë konkurrencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të energjisë dhe minierave.

Brenda strukturës organizative të ministrisë, përgjegjës për fushën e energjisë, përkatësisht BRE-të, është Departamenti për Energji dhe Miniera në kuadër të të cilit është Divizioni, i cili merret me fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, eficiencën dhe bashkëprodhimin.

Përgjegjësitë kryesore të këtij divizioni janë:

- Bën propozimin, draftimin dhe zbatimin e politikave dhe dokumenteve strategjike për fushën e BRE, EE dhe BP;
- Propozon, drafton dhe përcjellë implementimin e legjislacionit në fuqi për fushën e BRE, EE dhe BP;
- Bën draftimin e raporteve dhe monitorimin lidhur me implementimin e dokumenteve dhe strategjive për fushën e BRE, EE dhe BP;
- Bën koordinimin dhe raportimin e procesit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga angazhimet në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me burimet e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë dhe bashkëprodhimin.

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE):

- Lëshon autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit (autorizime preliminare, autorizime finale);
- Përcakton sistemin tarifor për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE;
- Është përgjegjës për sistemin e certifikatave të origjinës.

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH):

- Lëshon lejen ujore, e drejta për shfrytëzim të ujit, është bartëse e procedurës së dhënies me koncesion për shfrytëzimin e ujit;
- Lëshon leje mjedisore;
- Është përgjegjëse për lëshimin e lejeve për ndërtim (për prodhuesit mbi 20 MW të kapacitetit të instaluar).

- Autoritetet komunale:
 - Përgjegjës për dhënien e tokës për projekte të BRE;
 - Përgjegjës për lëshimin e lejeve të ndërtimit për prodhues nën 20 MW të kapacitetit të instaluar.
- Agjencia Pyjore e Kosovës:
 - Lëshon leje për përdorimin e pyjeve.
- KOSTT, përgjegjës për:
 - Kyçje në rrjetin e transmisionit;
 - Operator i tregut.
- KEDS përgjegjës për:
 - Kyçje në rrjetin e shpërndarjes;
 - Marrëveshjet e blerjes së energjisë (MBE) si furnizues publik.

Në disa raste, para ndërtimit, lejet shtesë janë të nevojshme varësisht nga lloji dhe lokacioni i centralit të BRE:

- Ministria e Infrastrukturës përgjegjëse për:
 - Leje për lidhje me infrastrukturën ekzistuese rrugore.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përgjegjëse për:
 - Lejet në rast të zonave me interes të veçantë, apo zonës arkeologjike.

c) Kategorizimi i procedurave për zhvillimin e projekteve të energjisë nga BRE-të do të rregullohet me UA të veçantë. Procedurat hartohen nga ZRrE. Ky proces do të përfundojë deri në fund të vitit 2013.

d) Shpërputhjet eventuale ndërmjet Ligjit Nr.03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit Nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat, do të analizohen dhe evitohen.

Aktualisht, e drejta për shfrytëzim të tokës dhe të pyjeve mund të jepet vetëm deri në 5 vite, që nuk mjafton për të ofruar garanci të duhur për investitorët, por këto dispozita pritet të harmonizohen me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Leja për shfrytëzimin e ujërave jepet për periudhë 40 vjeçare.

Ekzistojnë disa probleme në nivelin e pushtetit lokal ku në disa raste komuna të ndryshme japin Memorandume të Mirëkuptimit për dy investitorë për shfrytëzim të tokës, gjersa me Ligjin Nr.04/L-147 për Dhënie në Shfrytëzim dhe këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, këtë mund ta bëjë vetëm Kuvendi Komunal. Në raste të tilla ky problem i mosfunksionimit të ligjit në nivelin e pushtetit lokal do të evitohet.

Komuna duhet të ketë plane urbanistike dhe rregullative (me hollësi për kërkesat për ndërtim për mikrolokacione) dhe nëse kërkesa e investitorit është në pajtim me atë plan, komuna aprovon ndërtimin. Ndonëse shumica e komunave kanë plane urbanistike, megjithatë ende mungon zbërthimi në nivel të duhur i këtyre planeve. Periudha e përgjigjes është përshkruar të jetë 30 ditë dhe nëse komuna nuk përgjigjet në atë kohë, investitori lejohet të fillojë ndërtimin, sikur të ishte lëshuar leja e ndërtimit. Qëllimi i kësaj dispozite në Ligj ishte ulja e kohës së pritjes në këtë sektor, por meqë komunat kanë mungesë të kapaciteteve, këto dispozita kanë dhënë efekte kundërproduktive.

Modeli i marrëveshjes për blerjen e energjisë elektrike (MBE) i hartuar nga Furnizuesi Publik duhet të aprovohet nga ZRrE. Aprovimi i këtij modeli të marrëveshjes pritet të rrisë sigurinë për investitorët. Sipas skemës aktuale, MBE nënshkruhet vetëm pas ndërtimit të centralit me BRE dhe në kohën para hyrjes në operim, gjë që vështirëson financimin e projektit.

e) Për lëshimin e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë nga BRE është përgjegjëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Nga autorizimi preliminar dhe deri tek autorizimi final lëshuar nga ZRrE, në proces janë të përfshira institucionet e lartcekura, në piken (b). Pas lëshimit të autorizimit mund të fillojë ndërtimi i centralit.

Koordinimi më i mirë ndërmjet institucioneve të niveleve të ndryshme përgjegjëse për projektet e BRE-ve do të arrihet përmes harmonizimit të ligjeve dhe procedurave përkatëse.

f) Për plotësimin e aplikacioneve për autorizim, certifikim dhe licencim, në ndihmë të aplikuesit ofrohen informata përmes faqes së internetit të ZRrE-së. Në ueb faqen e ZRrE-së ekzistojnë informata për aplikuesit për autorizimet e lëshuara preliminare dhe për autorizimet finale të lëshuara për projektet e energjisë nga BRE. Aktualisht ekzistojnë informatat si në vijim:

Autorizime finale për (1.3 MW dhe 0.9 MW WPP dhe HC 23.1 MW) janë edhe 7 autorizime preliminare (1 për erë 30 MW, 6 për HC me gjithsej 102 MW) dhe 8 autorizime preliminare (2 për erë, me gjithsej 51 MW, 6 për HC me gjithsej 36 MW). Për hidrocentrale, autorizimet mund të jepen për më shumë se një HC përmes vendimit për Autorizim të ZRrE-së. Po ashtu, Ministria e Zhvillimit Ekonomik herë pas here publikon fletëpalosje me informatat e nevojshme për hapat procedurale që duhet t'i ndjekin investitorët për projektet në fushën e BRE-ve.

g) Koordinimi horizontal ndërmjet organeve të ndryshme të qeverisjes/administrative lidhur me procedurën e zhvillimit të projekteve të energjisë nga BRE-të është si në vijim:

Procedura për dhënien e Autorizimit fillon me dorëzimin e aplikacionit me dëshmitë dhe dokumentacionin e kërkuar. ZRrE është përgjegjëse për shqyrtimin e aplikacionit dhe komunikimin me aplikuesin deri në përmbylljen e dëshmimeve dhe dokumentacionit. Pas kësaj, Grupi Punues i ZRrE-së shqyrton aplikacionin dhe bën vlerësimin përfundimtar. Pasi që Grupi Punues vlerëson se aplikacioni është i plotë, ai paraqitet para Bordit për vendim. Procesi i njëjtë aplikohet për hapin e parë në Autorizimin preliminar edhe për hapin përfundimtar të Autorizimit.

Për çdo projekt hapi i parë: Aplikimi në MMPH për Pëlqim Mjedisor. Procedura e shqyrtimit dhe dhënies së përgjigjes është 70 ditë, nga dita e aplikimit.

Pas ndërtimit të impiantit, varësisht prej kapacitetit, personi juridik duhet të aplikojë në MMPH për Leje Mjedisore dhe për kapacitete të mëdha aplikon për Leje Mjedisore të Integruar.

Lidhur me shfrytëzimin e burimeve ujore, Ligji i ri për Ujërat e Kosovës është miratuar dhe është zëvendësuar me një procedurë autorizimi, e cila bëhet me tre hapa. Në hapin e parë pas autorizimit paraprak të garantuara nga ZRrE, investitori aplikon për lejen mbi kushtet e shfrytëzimit të ujit, e cila përshkruan të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për hapin e ardhshëm.

Posa ta këtë dokumentacionin gati dhe pak para marrjes së lejes së ndërtimit, investitori aplikon për marrjen e lejes për shfrytëzim të ujit. Pas ndërtimit të hidrocentralit dhe pas marrjes së lejes për shfrytëzim të ujit kjo leje mund të merret me jetëgjatësi deri në 40 vite për prodhim të energjisë, së bashku me udhëzimin administrativ për ujin (udhëzim administrativ mbi administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në periudhën e vlefshmërisë së lejes së ujit).

Tri projekte, nga të cilat: Dy centrale të erës 1.3 MW dhe 0.9 MW dhe një HCV 23.1 MW kanë kaluar me sukses Autorizimin. ZRrE-ja nxjerrë vendime zakonisht brenda 3 muajsh, por ka raste që kjo ndodh në një afat edhe më të shkurtër; menjëherë në takimin e ardhshëm të Bordit.

Autorizimi paraprak ka vlefshmëri prej dy vitesh dhe në atë kohë të gjitha lejet e nevojshme për autorizimin duhet të jenë siguruar. Praktika ka treguar se edhe 18 muaj mjaftojnë .

Autorizimi Preliminar i lëshuar nga ZRrE, që konfirmon se investitori ka kualifikime financiare dhe teknike dhe stafin për të zhvilluar, ndërtuar dhe menaxhuar gjeneratorin (centralin BRE).

Autorizimi final (përfundimtar) që lëshohet nga ZRrE, hapë rrugën për fillimin e ndërtimit të centralit dhe konfirmon se investitori ka siguruar të gjitha kontratat dhe lejet e nevojshme (përdorimi i tokës, përdorimi i ujit, kyçja në rrjet, leja mjedisore, leja e ndërtimit etj.) për këtë çështje.

Informatat rreth procedurave dhe hapave për ndërtim të centraleve nga BRE merren në ZRrE, por ZRrE nuk mund të quhet si *'one stop shop'* për mbështetjen e investitorëve.

h) Lidhur me specifikat e teknologjive të ndryshme për zbatimin e projekteve në fushën e BRE-ve, hapat ndërmjet autorizimit preliminar dhe final dallojnë në përputhje me llojin e teknologjisë, madhësinë e kapaciteteve dhe lokacionet ku zhvillohet projekti. Si shembull mund të theksohet dallimi i hapave dhe procedurave kur kemi të bëjmë me projektet që shfrytëzojnë biomasën drusore, në këtë rast nga ato që shfrytëzojnë ujin.

Përshtatjet për procedurën e autorizimit sipas specifikave të teknologjive të ndryshme të energjisë së ripërtëritshme do të kryhen përmes Udhëzimit të Planifikuar Administrativ për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe Rregullës së rishikuar të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë nga BRE-të dhe Rregullës për mbështetjen e energjisë elektrike, për të cilën është lëshuar certifikata e origjinës dhe procedurat e pranimit në skemën mbështetëse.

i) Lidhur me procedurat specifike, për instalimet e projekteve të vogla dhe prodhimin e decentralizuar të energjisë nga BRE-të (panelet solare në ndërtesa apo bojlerët e biomasës në ndërtesa), aktualisht nuk zbatohen procedura specifike.

Zbatimi i procedurave të thjeshtësuara planifikohet të bëhet sipas Udhëzimit Administrativ për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

j) Tarifat që kanë të bëjnë me aplikacionin për autorizime/licenca/leje për instalime të pajisjeve të kapaciteteve të reja të energjisë nga BRE, publikohen në faqen e internetit të ZRrE-së. Këto tarifa janë të lidhura me kostot administrative të aprovimit të këtyre lejeve. Aktualisht nuk ekziston një plan për shqyrtimin e tarifave.

k) Për organet lokale dhe rajonale për planifikimin, dizajnimin, ndërtimin dhe riparimin industrial dhe zonat e banimit për instalimin e pajisjeve dhe sistemeve që shfrytëzojnë burime të ripërtëritshme të energjisë për prodhim të energjisë elektrike, ngrohje dhe ftohje, duke përfshirë ngrohjen dhe ftohjen qendrore, aktualisht nuk ka ndonjë udhëzues zyrtar. Në këtë aspekt, mbështetja e organeve të pushtetit lokal dhe rajonal pritet që në të ardhmen të bëhet përmes institucioneve të reja, siç janë Zyrtat komunale/regjionale të energjisë.

l) Zyrtarët përgjegjës të ZRrE-së që merren me procedurat e autorizimeve, certifikimit dhe licencimit të instalimeve të pajisjeve që përdorin burimet e ripërtëritshme të energjisë përfitojnë nga trajnimet e herëpashershme për këto çështje. Këta zyrtarë kanë përgatitje të nivelit universitar në fushat përkatëse.

4.2.2. Specifikacionet teknike (neni 13(2) i Direktivës 2009/28/EC)

Specifikacionet teknike që duhet të përmbushen nga pajisjet dhe sistemet e energjisë nga burimet ripërtëritshme për të përfituar nga skemat mbështetëse do të përfshihen në Udhëzimin Administrativ për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

4.2.3. Ndërtesat (neni 13(3)j Direktivës 2009/28/EC)

(a) Sa i përket këtij neni, që ka të bëjë me rritjen e pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtëritshme në sektorin e ndërtesave, ekziston legjislacioni si në vijim :

- Ligji Nr. 04/L – 110 për Ndërtim (GZ/Nr.18/03 korrik 2013);
- Ligji nr. 2011/04-L-016 për Efiçencën e Energjisë (GZ. Nr.6/22 Korrik 2011);
- Rregullorja Teknike për Kursimin e Energjisë Termike dhe Mbrojtjen Termike në Ndërtesa, nr. 03/2009;
- Rregullorja nr. 01/2012 për Themelimin dhe Funksonimin e Komisionit për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë;
- Projekt-Kodi i Unifikuar i Ndërtimit në Republikën e Kosovës.

(b) Institucioni përgjegjës për zbatimin e legjislacionit për përdorimin e BRE-ve në ndërtesa është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

(c) Transpozimi i Direktivës për Performancën Energjetike në Ndërtesa 2010/3/KE (DPEN), bëhet me Ligjin për Ndërtim, si dhe nga Kodi i Ndërtimit, i cili planifikohet të aprovohet brenda vitit 2013.

(d) Në nivelin lokal/rajonar nuk ka masa ekzistuese apo të planifikuara lidhur me përdorimin e energjisë nga BRE-të në ndërtesa.

(e) Në legjislacionin e deritashëm, nuk ka dispozita për përdorimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në rregullore dhe kode të ndërtimit; kjo do të formulohet përmes Udhëzimit Administrativ për Përdorimin e BRE në Ndërtesa, i cili është planifikuar të aprovohet deri në fund të vitit 2013.

(f) Rritja e parashikuar e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ndërtesa deri më 2020 në sektorin publik dhe privat, sipas viteve përkatëse është paraqitur në tabelën 7, më poshtë. Të dhënat janë vjetore, apo për vitet përkatëse. Duhet të përfshihet edhe konsumi në ngrohje, ftohje dhe energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë).

Tabela 7–Pjesëmarrja e parashikuar e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në sektorin e ndërtesave (%)

	2009	2010	2015	2020
Sektorin e ekonomive familjare	48,4%	46,6%	49,8%	54,1%

Shërbime	6,6%	7,2%	14,3%	21,9%
Pjesëmarrja e sektorit të ndërtesave në konsumin e energjisë	40,2%	38,9%	43,2%	48,0%

g) Sa i përket nivelit minimal të konsumit të energjisë nga BRE-të në ndërtesat e reja dhe në ato që janë objekt renovimi, ky nivel nuk është përcaktuar. Aktualisht është në proces hartimi i UA që merr në konsideratë kërkesat për nivelin minimal të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ndërtesat e reja dhe të rinovuara.

h) Ju lutem përshkruani planet për sigurimin e rolit shembullor të ndërtesave në nivel vendor, rajonal dhe lokal, duke shfrytëzuar instalime të energjisë së ripërtëritshme apo për t'u bërë ndërtesa me zero energji nga 2012 e tutje. Me shqyrtimin e Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim (GZ. Nr.18/03 Korrik 2013) do të përcaktohen dispozitat sipas kërkesave të DPEN.

i) Promovimi i teknologjive eficiente të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në ndërtesa planifikohet përmes skemës mbështetëse për energjinë e ngrohjes nga BRE, të përcaktuara në UA për shfrytëzimin dhe mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE, i cili është në procedurë të miratimit.

4.2.4. Ofrimi i informatave (nenet 14(1), 14(2) dhe 14(4) të Direktivës 2009/28/EC)

(a) Lidhur me kërkesat e nenit 14 të Direktivës 2009/28/EC, në legjislacionin ekzistues nuk ka dispozita eksplicite. Planifikohet që kjo çështje të rregullohet me UA për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e Energjisë nga BRE, i cili do të aprovohet deri në fund të vitit 2013.

(b) Institucion përgjegjës për shpërndarjen e informatave në nivel të vendit është MZHE. Nuk ekzistojnë organe të tilla në nivel lokal dhe rajonal.

(c) Masat ekzistuese dhe të planifikuara në nivel rajonal dhe lokal për ofrimin e informatave paraqiten përmes zhvillimit të fushatave publike për ndërgjegjësim për EE dhe BRE. Këto fushata janë realizuara dhe do të vazhdojnë për t'u realizuar përmes spoteve televizive, garave shkollore, fletëpalosjeve, panove, punëtorive, trajnimeve, broshurave informuese, reklamave në radio etj.

d) Informatat e ofruara për aktorët përkatës (konsumatorë, ndërtues, instalues, arkitektë, furnizues të pajisjeve dhe automjeteve relevante), lidhur me masat për mbështetjen e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme (për energji elektrike, ngrohje dhe ftohje dhe në transport) janë: Ueb faqja e MZHE-së,

fletëpalosjet, broshurat, raportet e progresit të MZhE, raportet e kontraktuesve për zbatim të fushatës. Aktivitete të tilla janë planifikuar edhe për të ardhmen.

- e) Lidhur me programet për ndërgjegjësim publik për qytetarët në raport me shfrytëzimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme janë zhvilluar fushata të vazhdueshme publike. Të tilla fushata janë parashikuar edhe për në të ardhmen. Në të gjitha fushatat e realizuara dhe të planifikuara për promovimin dhe informimin për BRE është krijuar bashkëpunim me nivelin lokal.

4.2.5. Certifikimi i instaluesve (neni 14(3) i Direktivës 2009/28/EC)

Certifikimi i instaluesve sipas parimeve të përshkruara në Shtojcën IV të Direktivës 2009/28/EC do të jetë pjesë e Udhëzimit Administrativ për Mbështetjen e Shfrytëzimit të Energjisë nga BRE.

4.2.6. Zhvillimi i infrastrukturës elektroenergjetike (nenet 16(1), 16(3) dhe 16(6) të Direktivës 2009/28/EC)

(a) Ligjet kryesore që rregullojnë rrjetet energjetike dhe operimin e rrjeteve janë:

- Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë;
- Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë;
- Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike;
- Rregulla për Autorizimin e Ndërtimit të Kapaciteteve të Reja të Gjenerimit, e miratuar më 29.08.2011;
- Rregulla për Licencimin e Veprimtarisë Energjetike në Kosovë, e miratuar 29.08.2011;
- Rregulla për Vendosjen e Çmimeve për Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT);
- Rregulla për Vendosjen e Çmimeve për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH);
- Rregulla për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit të Energjisë;
- Kodi i Rrjetit;
- Kodi i Rrjetit – Kodi për Stacionet e Gjenerimit nga Era;
- Metodologjia për vendosjen e çmimeve për kyçje në transmision/KOSTT;
- Metodologjia për vendosjen e çmimeve për kyçje në shpërndarje/KEK;
- Rregullat teknike për kyçje;

- Kodi i Matjes;
- Kodi për Pajisjet Elektrike;
- Kodi për Standarde Elektrike;
- Kodi i Praktikave për Qasje në Tokë dhe Stabilimente;
- Kodi i Shpërndarjes;
- Kodi i Matjes për OSSH.

Obligimet në lidhje me integrimin e BRE-ve janë të përcaktuara në nenin 12, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë.

Operatorët e sistemit të transmisionit – dhe shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi bartësin e shpenzimeve të adoptimeve teknike, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforcimet e rrjeteve të tyre, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike që furnizojnë me energji elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Kosovës dhe të bazohen në kritere objektive, transparente e jodiskriminuese, veçanërisht duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga kyçja e këtyre prodhuesve me sistemin.

Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike që përdorë burime të ripërtëritshme të energjisë, apo bashkëprodhim e që dëshiron të lidhet në sistem, vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga kyçja, për të cilin vlerësim operatori i sistemit mund të ngarkojë një pagesë, e cila pasqyron kostot e arsyeshme të tij.

Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalimin e sistemeve siç janë kyçje në rrjet dhe përforcimet ndërmjet të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike, që përfitojnë prej tyre. Këto rregulla, parashtrihen për miratim në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, si dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë e Energjisë, si dhe me aktet e tjera nënligjore, rregullave apo kodeve.

Përgjegjësia për operim, mirëmbajtje, ndërtim dhe zhvillim të rrjetit bartet nga Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEK).

Bazuar në ligjin për energji dhe obligimet që dalin nga licenca, KOSTT-i ka sajuar një sërë kodesh teknike, të cilat janë të publikuara në tri gjuhët në faqen e KOSTT-it në internet.

(b) Në aspekt të zhvillimit të rrjeteve të transmisionit dhe shpërndarjes, për integrimin e energjisë nga burimeve të ripërtëritshme, KOSTT-i përgatitë dokumentet planifikuese afatgjata në vijim, të cilat rishqyrtohen çdo vit dhe i dorëzohen ZRrE-së për miratim:

- Planin për Zhvillimin e Transmisionit, për 10 vite;
- Planin e Adekuacisë së Gjenerimit, për 10 vite;
- Balancën Afatgjatë të Energjisë Elektrike, për 10 vite;

Në këto dokumente merret parasysh integrimi i gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në rrjet. Të gjitha dokumentet janë të publikuara në faqe të internetit.

Me ndihmën e shërbimeve këshillëdhënëse të ofruara përmes Instrumentit për Financime Direket të Energjisë së Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor, do të realizohet një studim për rrymimin e erës.

c) Rrjeti i energjisë elektrike do të zhvillohet vazhdimisht sipas planeve zhvillimore. Planet, gjithashtu përfshijnë dispozita për shtimin e shfrytëzimit të pajisjeve të teknologjisë informative, siç është shfrytëzimi i SCADA/EMS nga KOSTT-i. Për momentin nuk ka plane për stabilimente depozituese.

Për momentin nuk ka kurrfarë veprimtarie për shfrytëzimin e konceptit të Rrjetit Inteligent.

(d) Lidhur me kapacitete e interkonjeksionit me vendet fqinje, KOSTT-i ende nuk është anëtare e Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemeve të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO/E), prandaj EMS (OST i Serbisë) vazhdon t'i alokojë kapacitetet për interkonjeksionet e Kosovës. Ekzistojnë probleme për shkak të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit dhe për shkak të moskompensimit të rrjedhjeve të transitit. Pritet që situata të diskutohet dhe të zgjidhet deri në fund të vitit 2013.

- Linja 400 kV me Malin e Zi;
- Linja 400 kV me Maqedoninë;
- Linja 220 kV me Shqipërinë;

Linja 400 kV, ende nuk konsiderohet si interkonjeksion.

Bazuar në PZHT dhe studimet relevante në lidhje me zhvillimin e sistemit të transmisionit, janë të parapara disa projekte tejet të rëndësishme me ndikim në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit të transmisionit, në kuptim të brendshëm dhe regjional:

- Linja 400 kV Kosovë – Shqipëri me kapacitet prej 1300 MVA, që planifikohet të finalizohet deri në vitin 2015;
- Linja 400 kV Kosovë – Maqedoni me kapacitet prej 1300 MVA, që planifikohet të finalizohet deri në vitin 2020.

(e) Sa u përket procedurave për autorizime lidhur me infrastrukturën e rrjetit, gjendjes aktuale dhe kohës mesatare për marrjen e miratimit, situata përshkruhet si në vijim: Pas finalizimit të autorizimit preliminar nga ZRrE, zhvilluesit e kapaciteteve të reja të

gjenerimit nga burimet e ripërtëritshme paraqesin kërkesat e tyre, ose tek operatori i sistemit të transmisionit, ose tek OSSH, varësisht nga parashikimet e veta lidhur me mundësitë e kyçjes.

Dokumenti i aplikimit përmban të gjitha të dhënat relevante nga projektet e nevojshme për modelim kompjuterik, si dhe kohën e planifikuar të komisionimit etj. Në bazë të këtyre të dhënave, inxhinierët e planifikimit analizojnë ndikimin e projektit dhe propozojnë zgjidhjen më të mirë për kyçje. Procedurat (afatet kohore deri në nënshkrimin e marrëveshjes) janë të përshkruara në Metodologjinë për Ngarkesat për Kyçje. Koha mesatare prej 2-3 muajsh është normale dhe për momentin nuk ka plane për ta ndryshuar këtë procedurë.

Ndërtimi i kyçjeve në rrjet bëhet nga investuesi, në pajtim të dizajneve të miratuara nga operatori i sistemit. Pas ndërtimit, që mbikëqyret nga operatori i sistemit, instalimi i kyçjes në rrjet i dorëzohet operatorit të sistemit, i cili kryen operimin dhe mirëmbajtjen. Adaptimet teknike në rrjet, të cilat janë të domosdoshme për kyçjen vendosen në planin për zhvillimin e rrjetit dhe ekzekutohen para ndërtimit të kapaciteteve të gjenerimit nga BRE.

(f) Koordinimi mes miratimit të infrastrukturës së rrjetit dhe procedurave tjera të planifikimit administrativ, kryhet përmes ZRrE-së, pasi që ata lëshojnë autorizimin preliminar, i cili është i vlefshëm për dy vite dhe miratojnë për çdo vit versionet e azhurnuara të planeve për zhvillimin e rrjetit energjetik. Miratimi i Kërkesës për Kyçje bëhet pas miratimit preliminar të ZRrE-së, ndërsa miratimi përfundimtar nga ZRrE jepet pas miratimit të kërkesës për kyçje.

(g) E drejta e kyçjes me prioritet, apo kapacitetet të rezervuara për kyçje për stabilimentet e reja që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme, sipas planifikimit të rrjetit dhe procedurave për BRE bazohet në listën e aplikuesve të regjistruar pranë ZRrE-së e dërguar nga operatori i rrjetit.

h) Raste të kërkesave për të instaluar pajisje të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, por për të cilat nuk ekzistojnë kushte për kyçja për shkak të kapaciteteve të limituara të rrjetit nuk ekzistojnë.

(i) Sa i përket kostove dhe bartjes së adaptimeve teknike të publikuar nga operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes, rregullat janë të përshkruara në Metodologjinë për Ngarkesat për Kyçje, të cilat miratohen nga ZRrE dhe janë të bazuara në rregulla objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Rregullat gjenden në ueb faqen e KOSTT-it në internet.

(j) Sipas Metodologjisë për Ngarkesa për Kyçje, të gjitha kostot për kyçje dhe adaptim teknik barten nga gjeneratorët, ndërsa rregullat janë të barabarta për të gjitha llojet e gjeneratorëve. Metodologjia përfshin edhe ngarkesat për kyçje të thella.

Ekzistojnë plane për ndryshime të mundshme të metodologjisë për kyçje në rrjetin e shpërndarjes.

- (k) Sipas Metodologjisë për Ngarkesa për Kyçje, prodhuesit e kyçur më vonë do të ndajnë kostot e kyçjes me prodhuesit e kyçur fillimisht, proporcionalisht me kapacitetet e instaluara.
- (l) Operatorët e sistemit të transmisionit dhe shpërndarjes sigurojnë informata për prodhuesit e rinj lidhur me kostot, orarin e saktë për përpunimin e kërkesave të tyre dhe orarin indikativ për kyçjen në rrjet si në vijim:

Procedimi i kërkesave është i përshkruar në Metodologjinë për Ngarkesa për Kyçje, e cila miratohet nga ZRrE.

OST (KOSTT) ofron parashikimin e kostove të detajuara për investitorët potencialë. Zakonisht 1-2 muaj pas kompletimit të aplikimit, prodhuesit të interesuar i jepen parashikimi i kostove të kyçjes.

OSSH (KEDS) nuk ofron informata të tilla eksplicite. Përfshirja e tyre është e kufizuar dhe ata thjesht japin kushtet teknike për kyçje. Ata krijojnë një komision, i cili del në terren, ekzaminon lokacionin e stabilitetit të ri dhe përcakton pikën e kyçjes dhe kushtet teknike për miratimin e kyçjes, sipas rregullave teknike standarde të parapërcaktuara.

4.2.7. Operimi i rrjetit elektroenergjetik (neni 16(2) dhe 16(7) dhe (8) i Direktivës 2009/28/EC)

Obligimet lidhur me gjeneruesit nga BRE vijnë nga Ligji Nr.03/L-184 për Energjinë, respektivisht në nenin 12, paragrafët 1 dhe 5.

Gjatë dispeçimit të energjisë së prodhuar, Operatori i Sistemit të Transmisionit, ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sipas nevojës, duhet t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe bashkëprodhimi, sipas limiteve të specifikuara për qëllime të sigurimit të sistemit në Kodin e Rrjetit dhe në rregullat e kodet tjera.

Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që tarifat e transmisionit dhe të shpërndarjes për kyçje dhe shfrytëzim të sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes të mos diskriminojnë energjinë elektrike me prejardhje nga burimet e ripërtëritshme, e posaçërisht energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme në rajonet periferike dhe me dendësi të vogël të popullatës.

- (a) Transmisioni dhe shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme bëhet me prioritet në dispeçing nga operatorët e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes. Përrjashtim nga kjo bëhet kur ka raste kritike në rrjet, kur

energjia e prodhuar prej këtyre prodhuesve mund të zvogëlohet për të garantuar siguri dhe qëndrueshmëri.

- (b) Prioritetet që operatori i sistemit të transmisionit u jep prodhuesve të energjisë që shfrytëzojnë burime të ripërtëritshme, gjatë dispeçimit të energjisë elektrike të gjeneruar është përshkruar në pikën 4.2.7.
- (c) Me qëllim të minimizimit të shkurtimeve të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, si dhe masat e planifikuara, për shkurtimin e energjisë elektrike nga centralet e erës është parashikuar studimi për rrymimin e erës. Përveç kësaj, në rast nevojë, do të mund të krijohet edhe modeli i prodhimit të energjisë elektrike nga era.
- d) ZRrE nuk është e informuar për masat e planifikuara dhe as ka autoritet për t'i monitoruar ato.
- e) Sa i përket integritetit të stabilizimit të energjisë nga BRE në rrjetin e energjisë elektrike, si dhe obligimeve të prodhuesve të kësaj energjie lidhur me pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike, aktualisht ky treg në Kosovë është model tranzitor. Prodhuarit nga BRE nuk marrin pjesë në treg gjatë kohëzgjatjes së MBE-ve të tyre, sipas skemës FIT, pasi Furnizuesi Publik është i obliguar të blejë tërë energjinë elektrike të prodhuar nga BRE. Ende diskutohet nëse prodhuarit nga BRE, pas skadimit të MBE-së, do të marrin pjesë në treg, apo nëse atyre do t'u jepet e drejta për të hyrë në MBE me Furnizuesin Publik të Energjisë Elektrike, nën kushte të tjera.
- f) Rregullat për ngarkimin e tarifave të transmisionit dhe shpërndarjes janë përshkruar në Metodologjinë për Ngarkesat për Kycje të miratuara nga ZRrE, ndërsa tarifat kalkuloohen sipas këtyre rregullave.

4.2.8. Integrimi i biogazit në rrjetin e gazit natyror (neni 16(7) dhe neni 16(9) dhe (10) i Direktivës 2009/28/EC)

Në Kosovë nuk ekziston infrastruktura e gazit natyror dhe nuk ka plan afatshkurtër për ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes së tij.

Megjithatë, Ligji Nr.03/L-133 për Gazin Natyror përmban disa dispozita me të cilat sigurohet trajtimi jodiskriminues i biogazit dhe gazit nga biomasa, i cili përfshin:

- Paragrafi 3 i nenit 1, specifikon se dispozitat e Ligjit Nr.03/L-133 për Gazin Natyror do të jenë të aplikueshme edhe për biogaz dhe gaz të nxjerrë nga biomasa.
- Paragrafët 1.2 dhe 3 të nenit 3 të Ligjit Nr.03/L-133 specifikojnë se: Shfrytëzuesit e sistemit të transmisionit nuk duhet të jenë të diskriminuar, rregullat për shërbimet e sistemit do të përmbajnë kushtet dhe afatet jodiskriminuese, si dhe tarifa kosto-reflektive për shfrytëzimin e shërbimeve.
- Ngjashëm me dispozitat e mësipërme, paragrafët 1.2 dhe 3 të nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-133 përmbajnë dispozita identike, të cilat ndërlidhen me sistemin e shpërndarjes.
- Gjithashtu, neni 17 i Ligjit Nr.03/L-133 (për Qasjen e Palëve të Treta), paragrafi 1 siguron tarifa jodiskriminuese për qasje në sistemet e transmisionit dhe shpërndarjes.

a) Mosdiskriminimin e gazit të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë përmes tarifave të transmisionit dhe shpërndarjes, e siguron korniza ligjore, e cila shtjellon në mënyrë të duhur mënyrat për integrimin e gazit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në rrjetin e gazit natyror. Përveç neneve/paragrafëve të mësipërm, ligji përmban edhe nenin që shtjellon infrastrukturën e re (neni 19 i Ligjit Nr.03/L-133) me qëllim të sigurimit të investimeve për infrastrukturë të re, përfshirë zgjerimin e rrjetit, modifikimit të tij dhe ngritjes së kapaciteteve.

b) Për sa i përket vlerësimit të nevojave për infrastrukturën e gazit dhe zgjerimit të rrjetit të tij, në rast se do të vlerësohet ndërtimi i rrjetit të gazit dhe kurdo që kjo të ndodhë, procesi do të përfshijë edhe vlerësimin e mundësive për integrimin e gazit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

(c) Rregullat teknike për kyçjen e biogazit në rrjetin e gazit natyror dhe tarifatat përkatëse për kyçje nuk janë të përgatitura.

4.2.9. Zhvillimi i infrastrukturës për ngrohje dhe ftohje qendrore (neni 16(11) i Direktivës 2009/28/EC)

Sistemet dhe infrastruktura e ngrohjes qendrore (rrjetet) nuk janë të zhvilluara në nivel të kënaqshëm, ndërsa sistemet aktuale të NQ nuk shfrytëzojnë energji nga burimet e ripërtëritshme.

Kosova, gjithashtu ka miratuar Strategjinë për Ngrrohje Qendrore 2011-2018, në të cilën burimet e ripërtëritshme të energjisë trajtohen në mënyrë të veçantë. Në të specifikohet përdorimi i linjitet të lëngët, ndërsa shfrytëzimi i paqëndrueshëm i drurit për ngrohje duhet minimizuar. Shfrytëzimi i energjisë solare, mbeturinave komunale dhe mbetjeve drusore shihen si opsionet më premtuese të burimeve të ripërtëritshme

të energjisë për ngrohje qendrore. Masat stimuluese financiare për këto qëllime janë paraparë në Strategjinë e Ngrhjes, por ato ende nuk ekzistojnë.

Përcaktimi i kuotave obligative për furnizues të ngrohjes qendrore përmes BRE do të mund të merren në shqyrtim.

Prodhuesit e ngrohjes që eksportojnë ngrohje në rrjetin e NQ në të ardhmen mund të gëzojnë bonuse shtesë për prodhimin/përdorimin e ngrohjes nga BRE, bashkëprodhimi apo nga skemat mbështetëse për ngrohje nga BRE.

Mundësia e subvencionimit të zhvillimit të rrjetit të NQ me BRE do të shqyrtohet gjatë hartimit të Udhëzimit Administrativ për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE, i cili do të përmbajë edhe formulimet mbi skemat mbështetëse (skemat mbështetëse të ngrohjes nga BRE).

4.2.10. Biokarburantet dhe biolëngjet tjera – kriteret e qëndrueshmërisë dhe verifikimi i pajtueshmërisë (nenet 17 deri 21 të Direktivës 2009/28/EC)

Politika e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural është që të stimulojë shfrytëzimin e tokës për nevoja të prodhimit të ushqimit për njerëz dhe kafshë, për të zvogëluar në këtë mënyrë varësinë nga importi. Shfrytëzimi i tokës për prodhim të energjisë (drithëra energjetike, apo bimë për prodhim të biokarburanteve) nuk shtjellohet fare.

Rrjedhimisht, Kosova nuk ka plane konkrete për të prodhuar biokarburante nga produktet bujqësore dhe pyetjet vijuese janë vetëm pjesërisht të aplikueshme. Kriteret e planifikuara për qëndrueshmëri dhe vërtetim të pajtueshmërisë do të implementohen për import të biokarburanteve dhe prodhim të biokarburanteve nga lënda e parë e importuar.

- a) Lidhur me kriteret e qëndrueshmërisë për biokarburante dhe biolëngje në nivel kombëtar Projektligji për Naftën dhe Tregtim të Produkteve të Naftës në Kosovë shtjellon çështjet e biokarburanteve në përgjithësi, ndërsa caqet e konsumit të biokarburanteve në transport dhe kriteret e qëndrueshmërisë planifikohet të përcaktohen me Udhëzimin Administrativ për përdorim të Biokarburanteve në Transport.

Projektligji pritet të aprovohet gjatë pjesës së dytë të vitit 2013, ndërsa UA për përdorimin e biokarburanteve në transport do të miratohet deri në fund të vitit 2013 dhe të hyjë në fuqi nga janari i vitit 2014.

- b) Lidhur me sigurimin e përkrahjes financiare për biokarburantet, sipas kriterëve të qëndrueshmërisë të përcaktuara në nenin 17(2) deri (5) të Direktivës 2009/28/EC, UA për përdorim të biokarburanteve në transport do ta përcaktojë skemën mbështetëse me kushte të përshtatshme, së pari për importin e tyre e më pas për prodhimin vendor. Sidoqoftë, duhet të theksohet se kriteret e përshtatshmërisë parashikohet të fillojnë të implementohen në pjesën e dytë të vitit 2014.

- c) MTI-ja është institucion përgjegjës për monitorimin e përmbushjes së kriterëve. Organi mbikëqyrës për Vlerësimin e kriterëve të qëndrueshmërisë planifikohet të emërohet gjatë pjesës së parë të vitit 2014.
- d) Lidhur me nenin 17(3,4 dhe 5) të Direktivës 2009/28/EC, Statusi i zonave të mbrojtura bazohet në Ligjin Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës GZ. Nr.85/09 Nëntor 2010). Autoriteti që monitoron tokën dhe ndryshimet në statusin e tokave është Instituti për Mbrojtjen e Mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Legjislacioni kombëtar për administrimin (regjistrimin) e tokës përbëhet nga Ligji Nr.04/L-013 për Kadastrin,(GZ. Nr.13/1 Shtator 2011). Ndryshimi i statusit të tokave që janë zona të mbrojtura të biodiversitetit, apo shpallja e një toke (zone) zonë e mbrojtur, apo me biodiversitet të lartë, është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Autoriteti kombëtar kompetent për monitorimin e regjistrimit të tokave dhe ndryshimit të statusit të tokave është Agjencia Kadastrale e Kosovës.

- e) Zonat e mbrojtura rregullohen me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Nr. 03/L-233 (kapitulli 2, neni 8), kategorizimi i zonave të mbrojtura bëhet sipas kriterëve të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN).
- f) Procedurat për ndryshimin e statusit të tokës, nga toka bujqësore në tokë jobujqësore, rregullohen nga Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (GZ. Nr.30/23 Gusht 2013). Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimi Administrativ 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, dhe Udhëzimi Administrativ Nr.10/2010 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.

Në bazë të paragrafit 8.2 të nenit 8 të Ligjit Nr.02/L-26 për Tokën Bujqësore: “Organet komunale kompetente për bujqësi janë të obliguara që të mbajnë dëshmitë mbi tokën dhe destinimin e tokës, si dhe regjistrat e tokave, destinimi i të cilave është ndryshuar nga shfrytëzuesi”.

MBPZHR është duke zhvilluar një projekt për krijimin e një regjistri të tokave bujqësore.

- g) Ligjet në fuqi për sektorin e mjedisit dhe bujqësisë nuk marrin në konsideratë praktikën e mira agro-mjedisore dhe kërkesat tjera të pajtueshmërisë së përgjithshme (që kërkohen nga neni 17(6) i Direktivës 2009/28/EC), me rastin e parashikimit të lëndës së parë në Kosovë do të bëhet harmonizimi i ligjeve në aspektin e marrjes në konsideratë të këtyre praktikave të mira agro-mjedisore.

- h) Në të ardhmen do të analizohen mundësitë për krijimin e skemës vullnetare të 'certifikimit' për qëndrueshmëri të biokarburanteve dhe biolëngjeve, që përshkruhen në nënparagrafin e dytë të nenit 18(4) të Direktivës 2009/28/EC, në përputhje me kushtet dhe mundësitë që ka vendi.

4.3. Skemat mbështetëse për të promovuar shfrytëzimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, që aplikohen nga Pala Kontraktuese, apo grupi i palëve kontraktuese

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.03/L-184 për Energjinë, Ministria do të përcaktojë caqet vjetore dhe afatgjata (10-vjeçare), të konsumit të energjisë elektrike, apo ngrohjes së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi. Caqet e para të prodhimit të energjisë nga BRE janë përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për Prodhim të Energjisë Elektrike dhe Termike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë dhe Bashkëprodhimi, Nr. 06/2007. Ky udhëzim është shfuqizuar në vitin 2013 dhe është zëvendësuar me Udhëzimin Administrativ mbi Caqet e BRE, Nr. 01/2013.

Për momentin ekziston vetëm skema FIT për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE (biomasa dhe biogazi, era dhe hidrocentralet e vogla). Brenda vitit 2013, kjo skemë do të plotësohet me FIT për sistemet solare fotovoltaike.

Rregulla për Mbështetjen e Energjisë Elektrike, për të cilën është dhënë Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin në Skemat Mbështetëse është në zbatim dhe monitorohet nga ZRrE. Skema nuk ka ndonjë datë specifike të përfundimit.

Përveç kësaj, në të ardhmen do të merret në konsiderohet mundësia për zhvillimin e skemave në vijim:

- Lirimi, ose ulja e taksës doganore për pajisjet e BRE-ve (në juridiksion të MF-së);
Lirimi ose ulja e tatimit në fitim, për investimet në projektet e BRE që krijojnë punësim regjional (në juridiksion të MF-së);
- Krijimi i linjave kreditore me interes të ulët për projekte të BRE-ve (duke parashikuar bashkëpunimin e mundshëm me bankat zhvillimore);
- Tenderimi i hidrocentraleve të vogla dhe projekteve të energjisë nga era.

Tarifat nxitëse (Feed-in tariff)

- a) Tarifat nxitëse Feed-in si skema mbështetëse vullnetare për energjinë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet dhe centralet me erë dhe biogaz/biomasë përcaktohen në bazë të Rregullës për Mbështetjen e Energjisë Elektrike, për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranimin e Skemës Mbështetëse, të miratuar më 29.12.2010.

- b) ZRRé e harton skemën, i identifikon akterët e tregut që do ta implementojnë skemën, si dhe monitoron operimin dhe realizimin e skemës në kuptim të arritjes së trajektores indikative dhe caqeve të BRE.
- c) KOSTT akumulon të hyrat e nevojshme për blerjen e energjisë elektrike nga BRE, përmes taksës për energji nga burimet e ripërtëritshme. Të hyrat e grumbulluara shfrytëzohen për të plotësuar dallimin mes çmimit të energjisë elektrike në treg dhe FIT për FPEE. Furnizuesi publik është i obliguar që të blejë me prioritet tërë energjinë elektrike të prodhuar nga BRE dhe të pranuar në skemë.
- d) Skema Mbështetës me FIT të unifikohet ofrohet për 10 vite. Mbështetja përcaktohet nga metodologjia e ZRRé-së në nivelin që siguron kthim adekuat të kapitalit. Skemat FIT përshtaten për çdo vit në bazë të inflacionit edhe atë për çdo tarifë për secilën teknologji të BRE-ve. Tarifat feed-in janë të ndryshme për secilën teknologji, megjithatë të gjitha dispozitat tjera mbesin të njëjta për të gjitha llojet e teknologjive.

Në rast të rishikimit të tarifave Feed-in, ndryshimi i tyre nuk ndikon te prodhuesit e pranuar më parë në skemën mbështetëse, por vetëm te prodhuesit që mund të aplikojnë nga data e rishikimit.

e) Rishikimi i tarifave Feed-in nuk parashihet të bëhet në mënyrë periodike, por ZRRé, sipas kompetencave të saj ka të drejtë ta bëjë ndryshimin e tarifave kurdo që e sheh të nevojshme. Me rastin e rishikimit të Feed-in tarifave parashihet të përcaktohen edhe feed-in tarifat për sistemet fotovoltaike, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

a. Niveli i FIT është specifik për çdo teknologji, por nuk ka kriteret e tjera për dallim tarifor (sipas madhësisë, efijencës etj.). Niveli i Feed-in tarifave është:

- Hidrocentralet 63.3 €/MWh,
- Turbinat me erë 85.0 €/MWh,
- Centralet me biomasë dhe biogaz 71.3 €/MWh.

b. Bazuar në FIT, sipas caqeve të energjisë nga BRE, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013, deri në vitin 2020 pritjet të mbështetjet ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, si në vijim: 20.56 GWh energji fotovoltaike, 105 GWh nga biomasë, 302.22 GWh nga era dhe 436.5 GWh nga uji. Në këto kapacitete nuk përfshihen hidrocentralet e vogla ekzistuese dhe HC 'Zhuri'.

c. Mbështetja e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE përmes FIT nuk kushtëzohet me kriteret e efijencës së energjisë.

d. Skema ekzistuese e mbështetjes është përcaktuar me Rregullën për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe për Procedurat e Pranimi në Skemën Mbështetëse, të miratuar më 29.12.2010.

e. Skema ekzistuese FIT është funksionale për teknologjitë e caktuara.

f. Skema ekzistuese e mbështetjes FIT, e përcaktuar me Rregullën për Mbështetjen e Energjisë Elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe për Procedurat e Pranimi në Skemën e Mbështetjes, e miratuar më 29.12.2010, nuk ka datë specifike të përfundimit.

g. Në pikëpamje të përcaktuar të madhësisë maksimale dhe minimale të sistemeve, të cilat mund të përfitojnë nga skemat mbështetëse, është përcaktuar madhësia maksimale prej 10 MW vetëm për hidrocentrale të vogla. Për sisteme të tjera nuk janë përcaktuar nivelet e kapaciteteve që mund të përfitojnë nga skema.

h. Aktualisht FIT përbën të vetmen skemë mbështetëse që shfrytëzohet për të arritur caqet e energjisë nga BRE, prandaj nuk është e mundur që i njëjti projekt të përket nga më shumë se një masë mbështetëse.

i. Skema lokale/regjionale për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE nuk ekzistojnë.

j. Marrja e një tarife fikse sipas sistemit FIT dhe pranimi i një njësie prodhuese në skemën mbështetëse, mundësohet nëse:

- Ka hyrë në funksion deri në datën 30 qershor 2004;
- Ndodhet në territorin e Kosovës;
- Prodhon energji elektrike duke shfrytëzuar kapacitete gjeneruese me pajisje të reja;
- Prodhon energji elektrike për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës;

Përveç kësaj, për t'u pranuar në skemë mbështetëse, gjeneratorët e BRE duhet ta shfrytëzojnë një prej teknologjive të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë.

Me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, është përcaktuar vëllimi dhe madhësia e kapacitetit për BRE që duhet të përfitojë nga skema mbështetëse. Me këtë UA është përcaktuar faktori i kapacitetit për çdo teknologji të BRE, si dhe janë të përcaktuara caqet për energji elektrike të

prodhuar edhe për kapacitete të instaluara. Sasia e energjisë që tejkalon kufijtë e kapacitetit të përcaktuar në Udhëzim Administrativ nuk përfshihet në skemën FIT.

4.4. Skemat mbështetëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë së ngrohjes dhe ftohjes nga burimet e ripërtëritshme, të aplikuara nga Pala Kontraktuese, apo grupi i palëve kontraktuese

Deri me tani nuk ekzistojnë skema mbështetëse për energjinë nga burimet e ripërtëritshme për qëllime ngrohje dhe ftohje.

Me Draft Udhëzimin Administrativ për Shfrytëzimin dhe Mbështetjen e prodhimit të energjisë nga BRE, është propozuar aplikimi i skemës mbështetëse edhe për energjinë termike (ngrohjes dhe ftohjes) nga BRE. Një prej formave të propozuara të mbështetjes është aplikimi i grantit investues, apo pagesa për kapacitet për ndërtimin e instalimeve dhe stabilimenteve për ngrohje dhe ftohje nga BRE, duke shfrytëzuar biomasën, energjinë solare-termike dhe gjeotermike, me specifika të përcaktuara sa u përket teknologjive dhe madhësive të impianteve.

Do të shqyrtohen edhe mundësitë për vendosjen skema shtesë siç janë:

- Lirimi ose ulja nga taksat doganore dhe nga TVSH për pajisjet e BRE-ve (nën juridiksionin e MF);
- Krijimi i linjave kreditore me interes të ulët për projekte të BRE-ve (duke parashikuar bashkëpunimin e mundshëm me bankat zhvillimore);
- Inkurajimi i bashkëpunimit të grupeve të interesit për të siguruar shfrytëzim më të madh të biomasës, energjisë solare-termike dhe gjeotermike.

a) Deri më tani nuk ekzistojnë skema të tilla mbështetëse për bashkëprodhimin nga BRE. Me rastin e rishikimit të sistemit FIT, do të propozohet aplikim i bonusit shtesë për prodhimin/shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes nga bashkëprodhim prej BRE-ve.

b) Deri më tani nuk ekzistojnë skema të tilla mbështetëse.

Prodhimi i energjisë së ngrohjes dhe shpërndarja e saj duke shfrytëzuar rrjetin e NQ, në të ardhmen do të mund ta mbështetë nga bonuset shtesë për prodhimin/shfrytëzimin e ngrohjes nga bashkëprodhimi prej BRE, apo nga skemat mbështetëse për energjinë e ngrohjes nga BRE.

Po ashtu, kuota e caktuar obligative për furnizuesin e ngrohjes qendrore për energjinë nga BRE, do të propozohet të mbështetë sipas skemave për mbështetjen e prodhimit të ngrohjes nga BRE.

c) Deri më tani nuk ekzistojnë skema mbështetëse për prodhim në shkallë të ulët (kapacitetet e vogla) të energjisë termike nga BRE.

- d) Deri më tani nuk ekzistojnë skema mbështetëse për prodhim të energjisë termike nga BRE në industri.

4.5. Skemat mbështetëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë në transport nga burimet e ripërtëritshme, që aplikohen nga Pala Kontraktuese apo grupi i palëve kontraktuese

Deri më tani nuk ekzistojnë skema mbështetëse për shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në transport.

Masa kryesore për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme do të jetë kuota për shfrytëzimin e biokarburanteve në transport.

Përveç kësaj, do të shqyrtohet dhe zhvillohet skema vijuese:

- Përfshirja nga akciza për biokarburante të importuara (nën juridiksionin e MF).

Skema për obligimin me kuota

- (a) Projektligji për Naftën dhe tregtimin e Produkteve të Naftës në Kosovë do të trajtojë çështje që ndërlidhen me biokarburante në përgjithësi, ndërsa caqet për konsum të biokarburanteve në transport dhe kriteret e qëndrueshmërisë do të përcaktohen në Udhëzimin Administrativ për Përdorimin e Biokarburanteve në Transport.

Ky UA do t'i përcaktojë caqet për përdorimin e biokarburanteve për secilin vit që nga viti 2014, për të arritur cakun prej 10% në vitin 2020. Këto caqe do të jenë obligative për të gjithë furnizuesit e produkteve të naftës.

b) UA për përdorim të biokarburanteve në transport do t'i përmbajë caqet indikative për bioetanol dhe biodizel, por obligimi do të përcaktohet si përqindje e biokarburanteve që duhet të sillen në treg nga ndonjë furnizues i caktuar i produkteve të naftës.

- (c) UA për përdorim të biokarburanteve në transport do t'i specifikojë obligimet konkrete për përdorim të biokarburanteve.

(d) Obligimi do të jetë i detyrueshëm për të gjithë furnizuesit (mundësisht edhe për shpërndarësit – shitësit me pakicë) të produkteve të naftës.

(e) Dispozitat ndëshkuese janë parashikuar në projektligjin për Naftën dhe Tregtimin e Produkteve të Naftës në Kosovë.

(f) Sipas UA Nr.07/2012, për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, të gjithë shfrytëzuesit e naftës dhe produkteve të naftës duhet t'i paraqesin Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të dhënat mbi çdo lloj karburanti që vendosin në treg.

(g) Nuk parashihet ndonjë mekanizëm për modifikimin e caqeve, por sipas raporteve vjetore të MTI-së ajo i ka informatat mbi zhvillimin e tregut. Pasi që caqet do të rregullohen përmes UA-së për përdorimin e biokarburanteve në transport, në rast nevojë ky UA mund të ndryshohet.

4.6. Masat specifike për promovimin e përdorimit të energjisë nga biomasa

Në parashikime përdoret vetëm biomasa drusore nga pyjet. Në vitin 2003-2004 është kryer inventarizimi i pyjeve të Kosovës dhe kjo përbën bazën e të dhënave statistikore mbi pyjet. Një inventarizim i ngjashëm është realizuar edhe në vitin 2012, por të dhënat nga ky i fundit ende nuk janë në dispozicion.

Sipas inventarizimit, sipërfaqja e gjithmbarshme pyjore është 464.800 ha, nga të cilat 278.000 ha (ose 60%) janë të klasifikuara si pyje publike, ndërsa 185.920 ha (ose 40%) janë pyje private.

Vëllimi i gjithmbarshëm i drurit në pyje publike parashihet të jetë 33.5 milionë m³ (nga të cilat 25.9 milionë m³ me diametër më të madh se 7cm në lartësi të kraharorit), ndërsa në pyje private 19.5 milionë m³ (nga të cilat 14.5 milionë m³ me diametër më të madh se 7 cm në lartësi të kraharorit).

Shtimi vjetor i vëllimit të druve me diametër më të madh se 7 cm në lartësi të kraharorit është 1.165 m³. Ekziston, gjithashtu potenciali i tokës djerrinë, 20.000 deri 30.000 ha, prej të cilave një pjesë e konsiderueshme është e përshtatshme për pyllëzim.

Një nga problemet më të mëdha është fakti se 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private janë pre e veprimtarisë së pakontrolluar dhe joligjore.

4.6.1. Furnizimi me biomasë: për nevoja vendore dhe për eksport

Tabela 8 – Furnizimi me biomasë në vitin 2009

Sektori i origjinës		Sasia e burimeve vendore ²⁶	Import		Ekspert	Sasia neto	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)
			BE	Jo BE	BE/Jo BE		
A) Biomasa	<i>Nga të cilat:</i>						

²⁶ Sasia e resurseve në m³ (sipas mundësisë, ose në njësi tjera alternative) për kategorinë A dhe nënkategoritë e saj, si dhe në ton për kategoritë B dhe C dhe nënkategoritë e tyre.

nga pyjet ²⁷ :	1. Furnizim i drejtpërdrejtë me biomasë drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për gjenerim të energjisë	295008 (m ³)	-	7000 (m ³)	-	302008 (m ³)	40.1 ktoe
	<i>Opsionale – nëse ka në dispozicion informata, të cilat ju mund t'i ofroni për të detajuar llojet e stoqeve që bëjnë pjesë në këtë kategori:</i>	242568 (m ³)	-	-	-		35.6 ktoe
	a) prerjet	26220 (m ³)					2.25 ktoe
	b) mbetje nga prerjet (kurora, degë, lëvore, trung, degëzime)	26220 (m ³)					2.25 ktoe
	2. Furnizimi indirekt me biomasë drusore për gjenerim të energjisë						
	<i>Opsionale – nëse ka në dispozicion informata të mëtejme, ju lutem t'i detajoni:</i>						
	a) mbetjet nga zdrukthëtaria, punimet e drurit, industria e mobileve (pluhur druri dhe byk)						
	b) nga produktet e industrisë së pulpës dhe letrës (lëngje të zeza, vaj të rëndë)						
	c) druri i përpunuar - karburant						
	d) dru i ricikluar pas konsumit (dru i ricikluar për gjenerim të energjisë, mbetje amvisërie të drurit)						
	e) të tjera (ju lutem të definoni)						
B) Biomasa nga bujqësia dhe peshkataria:	<i>Nga të cilat:</i>						
	1. Rendimentet bujqësore dhe produktet e peshkatarisë të ofruara drejtpërdrejt për gjenerim të energjisë						
	<i>Opsionale - nëse ka në dispozicion informata të mëtejme, ju lutem t'i detajoni:</i>						
	a) rendimenti nga arat (drithëra, fara të vajit, kallam sheqeri, misër për silazh)						
	b) plantacionet						

²⁷ Biomasa nga pylltaria do duhej të përfshijë edhe biomasën nga industrinë e bazuara në pyje. Nën kategorinë e biomasës nga pylltaria duhet përfshirë karburantet solide të përpunuara, siç janë copëzat, peleti dhe briketi, të cilat duhet të përfshihen në nënkategoritë përkatëse sipas origjinës.

	<p>c) drunjtë me rotacion të shkurtër</p> <p>c) rendimentet tjera energjetike (barishte)</p> <p>d) algat</p> <p>e) të tjera (ju lutem t'i definoni)</p>						
	<p>2. Produktet dytësore bujqësore/mbetjet e përpunuara dhe produktet dytësore të peshkatarisë për gjenerim të energjisë</p>						
	<p><i>Opsionale - nëse ka në dispozicion informata të mëtejme, ju lutem t'i detajoni:</i></p> <p>a) kashta;</p> <p>b) plehrat;</p> <p>c) yndyra shtazore;</p> <p>d) mishi dhe eshtrat;</p> <p>e) produkte dytësore të ngurta (përfshirë farërat për vaj dhe vajin e ngurtësuar të ullirit);</p> <p>f) biomasa frutore (përfshirë lëvozhgat dhe kokrrat);</p> <p>g) produktet dytësore nga peshkataria;</p> <p>g) mbetjet nga verërat, ullinjtë, drunjtë frutorë;</p> <p>h) të tjera (ju lutemi t'i specifikoni).</p>						
C) Biomasa nga mbeturinat:	<i>Nga të cilat :</i>						
	1. Pjesa e biodegradueshme e mbeturinave të ngurta, përfshirë biombeturinat (mbeturinat e biodegradueshme nga kopshtet dhe parqet, ushqimi dhe mbetjet e kuzhinave nga amvisëritë, restaurantet dhe pikat e shitjes me pakicë dhe mbeturinat tjera të ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimit) dhe gazrat nga depozitat						
	2. Pjesa e biogradueshme e mbeturinave industriale (përfshirë letrën, kartonin, paletat)						
	3. Llumi nga kanalizimet						

Për konvertimin e sasisë së biomasës drusore në energji primare është shfrytëzuar faktori konvertues: për trunjtet e druve të prera është përdorur vlera kalorike 6.168 GJ/m³; për të gjitha llojet e mbetjeve të tjera nga druri është përdorur vlera kalorike 3.511 GJ/m³.

Përveç drurit, Kosova nuk ka shfrytëzuar lloje tjera të biomasës për gjenerim të energjisë, siç janë mbetjet industriale të letrës, druri i ricikluar, peshkataria, apo mbetjet tjera të degradueshme me origjinë rurale, apo urbane (sana, kashta, mbetjet ushqimore etj.).

Parashikimi për shfrytëzimin e biomasës për gjenerim të energjisë për vitet 2015 deri 2020 është paraqitur më poshtë (bazuar në kategorizimin e biomasës sipas tabelës 9).

Tabela 8 a–Parashikimi i furnizimit vendor me biomasë, në vitet 2015 dhe 2020

Sektori i origjinës		2015		2020	
		Sasia e pritur e resurseve vendore	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)	Sasia e pritur e resurseve vendore	Prodhimi primar i energjisë (ktoe)
A) Biomasa nga pylltaria:	1. Furnizim direkt me biomasë drusore nga pyjet dhe tokat tjera pyjore për gjenerim të energjisë	Sasia e gjithmbarshme e drurit parashikohet të jetë 660574.62 metër kub	80.6 ktoe	Sasia e gjithmbarshme e drurit parashikohet të jetë 689213.26 metër kub	83.96 ktoe
	2. Furnizimi indirekt me biomasë drusore për gjenerim të energjisë				
B) Biomasa nga bujqësia dhe peshkataria:	1. Rendimentet bujqësore dhe produktet e peshkatarisë të ofruara drejtpërdrejt për gjenerim të energjisë				
	2. Produktet dytësore bujqësore/mbetjet e përpunuara dhe produktet dytësore të peshkatarisë për gjenerim të energjisë				
C) Biomasa nga mbeturinat:	1. Pjesa e biodegradueshme e mbeturinave të ngurta, përfshirë biombeturinat (mbeturinat e biodegradueshme nga kopshtet dhe parqet, ushqimi dhe mbetjet e kuzhinave nga amvisëritë, restorantet dhe pikat e shitjes me pakicë dhe mbeturinat tjera të ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimit) dhe gazrat nga deponitë				
	2. Pjesa e biogradueshme e mbeturinave industriale (përfshirë letrën, kartonin, paletat)				
	3. Llumi nga kanalizimet				

Aktualisht, Kosova nuk kultivon kultura bujqësore për nevoja të prodhimit të energjisë. Duhet theksuar se mundësitë e Kosovës për të kultivuar produkte bujqësore për gjenerim të energjisë janë tejet të kufizuara.

Tabela 9 – Përdorimi aktual i tokave bujqësore për prodhimin e produkteve të dedikuara për energji

Përdorimi i tokave bujqësore për prodhimin e produkteve të dedikuara për energji	Sipërfaqja (ha)
1) Toka e përdorur për trungje me rotacion të shkurtër (shelgje, plepa)	0
2) Toka e përdorur për rendimente tjera energjetike, siç janë barishtet (bar kallami, shkurre), melekuqe	0

4.6.2. Masat për rritjen e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë parasysh shfrytëzuesit tjerë të biomasës (sektorët e bazuar në bujqësi dhe pylltari)

Mobilizimi i burimeve të reja të biomasës

- (a) Lidhur me nivelin e degradimit të tokës bujqësore dhe pyjore, nuk ekzistojnë të dhëna në dispozicion.
- (b) Lidhur me tokën e punueshme, por të pashfrytëzuar, nuk ekzistojnë të dhëna.
- (c) Ende nuk janë propozuar kurrfarë masash për inkurajimin e shfrytëzimit të tokës së punueshme të pashfrytëzuar, tokës së degraduar etj., për qëllime të kultivimit të kulturave energjetike.
- (d) Nuk është planifikuar shfrytëzimi i materialeve primare (siç është plehu shtazor) për prodhim të energjisë.
- (e) Për inkurajimin e prodhimit dhe shfrytëzimit të biogazit ekzistojnë politikat shtetërore, të cilat konsistojnë në feed-in tarifën për bogazin.
- (f) Lidhur me planifikimin e masave për avancimin e teknikave për menaxhimin e pyjeve, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020 parasheh zhvillimin e projektit për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve.

Ndikimi në sektorët e tjerë:

- (a) Aktualisht nuk ekziston ndonjë skemë për monitorimin e ndikimit të biomasës së shfrytëzuar për gjenerim të energjisë në sektorët e ndërlidhur me sektorin e bujqësisë dhe atë të pylltarisë.

(b) Nuk ka në dispozicion informata lidhur me zhvillimet e pritura në sektorë tjerë të ndërlidhur me bujqësinë dhe pylltarinë që mund të kenë ndikim në përdorimin për nevoja energjetike.

4.7. Përdorimi i planifikuar i transfereve statistikore mes Palëve Kontraktuese dhe pjesëmarrja e planifikuar në projekte të përbashkëta me Palë tjera Kontraktuese dhe me shtete të treta

Për shkak të afateve kohore të kufizuara për arritjen e caqeve, mungesës së projekteve të përbashkëta dhe mungesës së përvojës në çështje që ndërlidhen me transfere statistikore dhe skema të përbashkëta mbështetëse, në planin afatshkurtër Kosova nuk parashikon shfrytëzimin e mekanizmave të fleksibilitetit të përcaktuar në nenet 6 deri 11 të Direktivës 2009/28 dhe në nenet 8 dhe 9 të Vendimit të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për implementimin e Direktivës 2009/28/EC dhe për ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, me ndryshimin e legjislacionit ekzistues, veçanërisht në sektorin e energjisë, do të mundësohet shfrytëzimi i mekanizmave fleksibilë në bazë të rregullave të përshkuara nga Qeveria.

Pasi që Kosova planifikon të arrijë dhe të tejkalojë cakun obligativ të energjisë nga BRE përmes masave për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, ekziston potencial për transferin statistikor energjetik të sasisë shtesë të energjisë, mbi trajektoren indikative, përmes mekanizmave të ndryshëm fleksibilë të bashkëpunimit, por kjo mundësi mbetet të planifikohet në të ardhmen. Në anën tjetër, në rast se raporti i rregullt për implementimin e PKVBRE dhe për progresin e shënuar drejt arritjes së caqeve sugjeron se Kosova nuk është në gjendje të plotësojë caqet obligative vetëm nga prodhimi vendor, do të merren hapa adekuatë për t'i hulumtuar mundësitë për shfrytëzimin e këtyre mekanizmave.

5. VLERËSIMET

5.1. Pjesëmarrja e përgjithshme e parashikuar nga teknologjitë e ndryshme të energjisë nga burimet e ripërtëritshme për plotësimin e caqeve obligative të vitit 2020 dhe trajektorës indikative të ndërmjetme për pjesëmarrjen e burimeve të ripërtëritshme në energjinë elektrike, ngrohje dhe ftohje dhe në transport

Pjesëmarrja e energjisë nga BRE dhe trajektorja indikative është paraqitur në tabelat përkatëse 10 deri 12. Dallimi ndërmjet caktimit vullnetar të përcaktuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë dhe caqeve të BRE, sipas Vendimit të KM Nr. 2/2012/04 MC të datës 18 tetor 2012, ka të bëjë me parashikimin e prodhimit të energjisë elektrike nga BRE, siç është paraqitur në tabelën 10.

Spektori i energjisë elektrike

Sipas caqeve të BRE të përcaktuara në UA, burimet kryesore të ripërtëritshme të përdorura për gjenerim të energjisë elektrike do të jenë uji dhe era, ndërsa një pjesë e vogël do të prodhohet nga biomasa dhe me burime solare. Në vitin 2020, pjesëmarrja e planifikuar e energjisë nga llojet e ndryshme të BRE- në brutokonsumin final të energjisë elektrike është 79% me ujë (madhësia prej <1 MW do të mbulojë 4.3%, madhësia 1-10 MW do të mbulojë 51.3% ndërsa > 10 MW do të mbulojë 23.4% të kësaj energjie), 14.8% nga erërat, 5.2% nga biomasa solide dhe 1% nga sistemet fotovoltaike siç është paraqitur në figurën 1.

Kapacitetet e planifikuara shtesë, si hidrocentrale të vogla <10 MW arrijnë 240 MW. Hidrocentrali Zhur, me 305 MW, është i vetmi hidrocentral më i madh i planifikuar për të hyrë në funksion në vitin 2017. Kostoja e ndërtimit të këtyre kapaciteteve prodhuese energjetike pritet të përballohet nga sektori privat.




Figura 2 – Pjesëmarrja e teknologjive të ndryshme të BRE në sektorin e energjisë elektrike

Ngrohja dhe ftohja

Ngjashëm me situatën aktuale, shfrytëzimi i biomasës për ngrohje do ta mbajë rolin e vet dominues për arritjen e caceve të BRE për ngrohje dhe ftohje deri në vitin 2020, i përcjellë nga energjia solare dhe pompat termike.

Në vitin 2020, pjesëmarrja e planifikuar e energjisë nga llojet e ndryshme të BRE-në brutokonsumin final të energjisë termike për ngrohje dhe ftohje do të jetë 95.2% nga biomasa solide, 4.3% nga energjia solare dhe vetëm 0.4% nga pompat termike që shfrytëzojnë energji aerotermike, gjeotermike dhe hidrotermike, siç paraqitet në Figurën 3.

Kostoja e ndërtimit të këtyre kapaciteteve prodhuese energjetike pritet të përballohet nga sektori privat.




Figura 3 – Pjesëmarrja e teknologjive të ndryshme të BRE në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes

Transporti

Energjia nga burimet e ripërtëritshme për transport deri në vitin 2020 planifikohet të përbëhet vetëm nga biokarburantet. Në parashikimin e konsumit të energjisë në sektorin e transportit në Balancën Afatgjatë të Energjisë 2013-2022, nuk është marrë parasysh konsumi i energjisë elektrike në sektorin e transportit. Në vitin 2020, BRE të planifikuara në transport do të jenë 36.33 ktoe, me shfrytëzim të planifikuar të biodizelit (77%) dhe bioetanolit (23%), vlera këto që korrespondojnë me përqindjet që në treg i mbajnë nafta dhe benzina.




Figura 4 – Pjesëmarrja e teknologjive të ndryshme të BRE në transport

Tabela 10.a: Vlerësimi i potencialit të disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në energjinë elektrike 2010-2014

	2009		2010		2011		2012		2013		2014	
	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh
<i>Hidro:</i>												
<1MW	1.76		1.76 1.76	9.14 9.14	1.76 1.76	9.14 9.14	1.76 1.76	14.86 14.86	1.76 1.76	13.84 13.84	1.76 1.76	14.73 14.73
1MW–10 MW	9.08 9.08	31.9 31.9	9.08 9.08	36.29 36.29	9.08 9.08	24.49 24.49	9.08 9.08	35.64 35.64	9.08 9.08	35.06 35.06	39.08 69.08	169.17 304.13
>10MW	35	87.9	35	110.2	35	71	35	81	35	82	35	82
<i>Nga pompat termike:</i>												
Gjeotermike												
<i>Solare:</i>												
Fotovoltaike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1 3	2.06 6.18
Energji solare e koncentruar												
Baticë, valë, oqean												
<i>Erë:</i>												
Në tokë	0.00	0.00	1.35 1.35	0.45 0.45	1.35 1.35	0.28 0.28	1.35 1.35	2.56 2.56	1.35 1.35	2.72 2.72	31.35 31.35	63.2 63.2
Në bregdet												
<i>Biomasë:</i>												
Solid	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1 2	7.5 15
Biogaz												
<i>biolëngje²⁸</i>												
TOTAL	45.84 45.84	119.8 119.80	47.19 47.19	156.08 156.08	47.19 47.19	104.91 104.91	47.19 47.19	134.06 134.06	47.19 47.19	133.62 133.62	109.19* 142.19**	338.66* 485.24**
<i>nga të cilat në BP</i>												

*)Kapacitetet e instaluara dhe energjia që korrespondon me cakun 25%

²⁸Duke marrë parasysh vetëm ato që përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë sipas nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC nënparagrafi i fundit.

**) Kapacitet të instaluar dhe energji që korrespondon me cakun 29.47%

Tabela 10.b: Vlerësimi i potencialit të disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të BRE për energji elektrike 2015-2020

	2015		2016		2017		2018		2019		2020	
	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh	MW	GWh
Hidro:												
<1MW	1.76	13.84	1.76	14.73	1.76	13.84	1.76	16.39	6.76	38.89	8.76	47.89
	1.76	13.84	1.76	14.73	4	34.95	6	55.61	10.00	57.53	16.00	87.47
1MW-10 MW	49.08	215.06	59.08	259.06	74.08	305.06	89.08	396.51	94.08	419.01	99.08	441.51
	149.08	665.06	159.08	709.16	166.84	733.95	184.84	810.29	200.84	895.37	234.84	1045.43
>10MW	35	82	35	82	340	480	340	476	340	476	340	476
<i>Nga pompat termike:</i>												
Gjeotermike												
Solare:												
<i>Fotovoltaike</i>	1	2.06	2	4.12	2	4.12	4	8.24	4	8.24	5	10.3
	4	8.24	6	12.35	7	14.41	8	13.47	9	18.53	10	20.59
<i>Energji solare e koncentruar</i>												
Baticë, valë, oqean												
Erë:												
<i>Në tokë</i>	31.35	63.2	41.35	83.31	51.35	103.46	62.15	125.22	62.15	125.22	62.15	125.22
	70	141.04	90	181.33	110	221.63	130	261.92	140	282.07	150	302.22
<i>Në bregdet</i>												
<i>Biomasë</i>												
<i>Solide</i>	1	7.5	2	15	2	15	4	30	4	30	5	37.5
	4	30	6	45	8	60	10	75	12	90	14	105
<i>Biogaz</i>												
<i>biolëngje²⁹</i>												
TOTAL	119.19	383.66	141.19	458.22	471.19	921.48	500.99	1052.36	510.99	1097.36	519.99*	1138.42*
	263.84	940.17	297.84	1044.58	635.84	1544.941	678.84	1692.296	711.84	1819.503	764.84**	2036.71**
<i>nga të cilat në BP</i>												

²⁹Duke marrë parasysh vetëm ato që përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë sipas nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC nënparagrafi i fundit

*)Kapacitet të instaluar dhe energji që korrespondon me cakun prej 25 %

**) Kapacitet të instaluar dhe energji që korrespondon me cakun prej 29.47 %

Tabela 11: Vlerësimi i potencialit të disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ngrohje/ftohje 2010-2020

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Gjeotermike (pa temperatura të ulëta ngrohja gjeotermike në aplikacionet e pompave termike)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Solar	0,60	0,61	0,63	0,64	1,29	1,93	3,22	5,16	7,09	9,03	10,96	12,90
Biomasë:	234,70	236,35	241,93	243,70	246,39	251,37	256,45	261,64	266,94	272,52	278,22	284,05
<i>Solid</i>	234,70	236,35	241,93	243,70	246,39	251,37	256,45	261,64	266,94	272,52	278,22	284,05
<i>Biogaz</i>	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
<i>Biolëngje</i> ³⁰	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Energjia nga pompat termike: - aerotermike -gjeotermike - hidrotermike	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,01	0,06	0,26	0,52	0,77	1,03	1,29
Total	235,30	236,96	242,56	244,34	247,68	253,32	259,74	267,06	274,55	282,32	290,21	298,24
Nga të cilat NQ ³¹												
Nga të cilat biomasë në ekonomi familjare ³²												

³⁰ Duke marrë parasysh vetëm ato që përmbushin kriteret e qëndrueshmërisë sipas nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC nënparagrafi i fundit

³¹ Ngruhja dhe/apo ftohja qendrore nga gjithsej konsumi i ngrohjes dhe ftohjes (RES-DH).

³² Nga konsumi i përgjithshëm i ngrohjes dhe ftohjes me energji nga burimet e ripërtëritshme, tërë shuma e biokarburanteve

Tabela 12: Vlerësimi i potencialit të disponueshëm në Kosovë për secilën teknologji të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në transport 2010-2020 (ktoe)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Bioethanol/bio-ETBE	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0.75	1.54	2.36	3.17	4.85	6.57	8.35
Nga e cila biokarburante ³³ Neni 21(2)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Nga të cilat të importuara ³⁴	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0.75	1.54	2.36	3.17	1.62	1.64	1.67
Biokarburante	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	2.52	5.17	7.91	10.63	16.23	22.01	27.97
Nga e cila biokarburante Neni 21(2)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Nga të cilat të importuara ³⁵	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	2.52	5.17	7.91	10.63	5.41	5.50	5.59
Hidrogjen nga burimet e ripërtëritshme të energjisë	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Nga e cila transport rrugor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Nga e cila transport jorrugor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Të tjera (si biogaz, vajra perimesh, etj.) –	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Nga e cila biokarburante ²⁹ Neni 21(2)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
Total	0,10	0,07	0,13	0,00	0,00	3,27	6,71	10,27	13,80	21,08	28,59	36,33

³³ Biokarburantet që janë të përfshira në nenin 21(2) të Direktivës 2009/28/EC

³⁴ Nga e tërë shuma e bioethanol/bio-ETBE

³⁵ Nga e tërë shuma e biokarburanteve

5.2. Pjesëmarrja e përgjithshme e parashikuar nga masat e efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë për t'i përmbushur caqet e obligueshme deri në vitin 2020 dhe trajektoren e përkohshme indikative për pjesëmarrjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në bruto konsumin e energjisë elektrike, ngrohje dhe ftohje dhe transport

Pjesëmarrja e parashikuar nga masat e efijencës dhe kursimit të energjisë të përfshira në PKVBRE është llogaritur në bazë të Planit të Veprimit për Efijencë të Energjisë, i Planit të Kosovës të Veprimit për Efijencë të Energjisë (PKVEE), i aprovuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. PKVEE 2010-2018 përcakton cakun indikativ të kursimit të energjisë prej 9% të konsumit prej 1021.08 ktoe. Sasia e energjisë që Kosova synon ta kursejë deri në fund të 2018 është 91.89 ktoe.

Tabela 1 në kapitullin 2 përmban dy skenarë të bruto konsumit final të energjisë: skenarin bazë dhe skenarin me efijencë të energjisë dhe dallimi ndërmjet këtyre dy skenarëve në vitin 2018 përfshin shumën e parashikuar të kursimeve të energjisë sipas Planit të Kosovës të Veprimit për Efijencë të Energjisë.

Konsumi final i energjisë sipas sektorëve të konsumit është paraqitur në përqindje sipas të dhënave preliminare për vitin 2012, është marr nga Balanca e Energjisë e Kosovës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe është paraqitur në Figurën 5.

■ Sektori i industrisë ■ Sektori i amvisërisë ■ Sektori i shërbimeve
■ Sektori i bujqësisë ■ Sektori i transportit




Figura 5 – Konsumi final i energjisë sipas sektorëve për vitin 2012 (të dhëna preliminare)

Sektori i ekonomive familjare (amvisërisë)

Sektori amvisërisë është sektori më konsumin final të energjisë më të madh në Kosovë. Më 2012, konsumi final i energjisë në sektorin e amvisërisë ishte 498.71 ktoe, apo 39.53 % të gjithëj konsumit final të energjisë.

Ekzistojnë dy objektiva strategjike që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me themelimin e kornizës ligjore dhe institucionale për promovimin e efijencës së energjisë:

- Ngritja e standardit jetësor në sektorin e banimit;
- Rregullimi i fushës së ndërtimit përmes krijimit të rregulloreve teknike në pajtim me standardet e BE-së.

Promovimi i efijencës së energjisë në ndërtesat kolektive do të jetë prioriteti kryesor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitet në vijim.

Në PKVEE-në e dytë janë përfshirë katër masat e sektorit banesor si në vijim:

- Përmirësimi i EE përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në ndërtesat individuale të banimit;
- Përmirësimi i EE përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në sektorin banesor;
- Përmirësimi i EE përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në ndërtesat kolektive të banimit;
- Përmirësimi i EE përmes informimit të vazhdueshëm për efijencë të energjisë.

Sektori i transportit

Sektori i transportit është sektori i dytë për nga niveli i konsumit të energjisë në Kosovë. Më 2012 konsumi final i energjisë në sektorin e transportit ishte 336.47 ktoe, apo 26.67% të gjithëj konsumit final të energjisë.

Ekzistojnë dy dokumente kryesore të planifikimit të politikave në sektorin e transportit:

- Strategjia e Transportit 'Multimodal Transport' dhe Plani i Veprimit;
- Strategjia e Ministrisë së Infrastrukturës (2011 – 2014).

Synimi kryesor i Ministrisë së Infrastrukturës është që të kontribuojë në rritjen ekonomike përmes themelimit të një sistemi efikas dhe të integruar multimodal – rrugë, hekurudhë, ajër.

Në PKVEE-në e dytë janë përfshirë 3 masat për sektorin e transportit si në vijim:

- Përmirësimi i EE përmes vazhdimit të fushatës informuese për promovimin e eko-ngasjes;
- Inspektimet sistematike të kushteve teknike të automjeteve;

- Përmirësimi i sistemit të transportit publik në qytetin e Prishtinës.

Sektori i industrisë dhe i NVM-ve

Industria është sektori i tretë për nga niveli i konsumit të energjisë në Kosovë. Më 2012, konsumi final i energjisë në sektorin e industrisë ishte 290.68 ktoe, apo 23.04%, të gjithsej konsumit final të energjisë.

Në PKVEE-në e dytë janë përfshirë dy masat si në vijim:

- Përmirësimi i EE përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në NVM,
- Përmirësimi i EE përmes zbatimit të masave të efijencës së energjisë në ndërmarrjet industriale.

Sektori terciar (shërbime)

Më 2012, konsumi final i energjisë në sektorin e shërbimeve ishte 115,19 ktoe, apo 9.13%, të gjithsej konsumit final të energjisë.

Masat e efijencës së energjisë në sektorin terciar që përfshin institucionet e administratës publike, kujdesit shëndetësor etj., do të jenë në projektet qendrore investuese që do të zbatohen në PKVEE-në e dytë. PKVEE e dytë përmban pesë masa për zbatim, të cilat do të financohen nga buxheti shtetëror i Kosovës, buxhetet komunale dhe IFN-të. Më shumë se 200 ndërtesa do të rinovohen duke zbatuar projekte investuese në aktivitetin e sipërpërmendur.

Në PKVEE-në e dytë janë përfshirë pesë masa për sektorin terciar, si në vijim:

- Përmirësimi i EE përmes renovimit të ndërtesave publike në komuna;
- Përmirësimi i EE përmes renovimit të ndërtesave qeveritare;
- Përmirësimi i EE përmes renovimit të ndërtesave publike (ndërtesave komunale);
- Përmirësimi i EE përmes renovimit të ndërtesave komunale dhe ndriçimit të rrugëve;
- Përmirësimi i masave të EE përmes auditimit të energjisë.

5.3. Vlerësimi i ndikimeve (opsionale)

Meqë shumica e masave vetëm janë diskutuar, bazuar në propozimet e përfaqëruara dhe meqë nuk ka përvojë aktuale me masën e vetme mbështetëse në zbatim (FIT) nuk ka të dhëna përkatëse për të përcaktuar ndikimin e masave.

5.4. Përgatitja e PKVBRE dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij

- a) Gjatë procesit të hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Burime të Ripërtëritshme të Energjisë, autoritetet lokale kanë luajtur rolin e tyre përmes diskutimeve publike dhe pjesëmarrjes në punëtoritë e organizuara për këtë proces.

Krahas ministrisë përgjegjëse, MZHE-së, palët tjera vijuese janë përfshirë aktivisht në përgatitjen e këtij plani të veprimit me informatat e tyre në kuadër të përgjegjësive të tyre:

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRrE) me përshkrimin e procedurave të autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit të energjisë, sistemin e tarifave për blerjen e energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe sistemin e certifikatave të origjinës;
- Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) me përshkrimin e zhvillimit të infrastrukturës së energjisë elektrike dhe operimit të rrjetit të energjisë elektrike;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me përshkrimin e përdorimit të energjisë nga BRE në sektorin e ndërtesave;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me përshkrimin e kornizës rregullative për biokarburante (dhe biolëngje tjera), dhe skemës mbështetëse për promovimin e përdorimit të biokarburanteve në transport;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) me përshkrimin e përdorimit të biomasës për prodhim të energjisë;
- Ministria e Financave (MF) me sugjerimet për masat fiskale.

(b) Lidhur me strategjitë rajonale dhe lokale të energjisë nga BRE nuk parashikohet zhvillimi i tyre nëpër komuna, një nga masat e propozuara për arritjen e caqeve të BRE është themelimi i zyrave komunale të energjisë me qëllim të mbështetjes së komunave. Përgjegjësia për arritjen e caqeve të PKVBRE do të mbetet mbi MZHE-në dhe do të jetë në koordinim me të gjitha zyrat komunale të energjisë për të siguruar pajtueshmëri me cakun shtetëror. Komisioni Evropian ka themeluar pesë agjenci rajonale për zhvillim, por për themelimin e tyre nuk ka bazë ligjore.

(c) Gjatë procesit të hartimit të Planit janë zhvilluar konsultimet publike, sidomos në fazën finale të përgatitjes së PKVBRE në Prill dhe Maj 2013. Për këtë qëllim, një draft i Planit është dërguar tek të gjitha palët e interesit dhe pastaj është mbajtur një punëtori me palët e interesit, përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse dhe shoqërinë civile.

(d) Institucioni përgjegjës për përcjelljen e Planit të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë është Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

(e) Qeveria do ta miratojë PKVBRE (2011-2020), të hartuar nga Ministria në përputhje me Ligjin për Energji.

Monitorimi i rregullt dhe raportimi periodik për arritjen e caqeve të energjisë nga BRE janë përshkruar në nenin 11, paragrafin 1.2 dhe nenin 13, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë.

Ligji i rishikuar për Energji Nr.03/L-184 pritet t'i bëjë më të qarta dispozitat e monitorimit të Planit. MZHE do të obligohet që të monitorojë zbatimin e PKVBRE dhe do të përgatisë raport periodik për zbatimin e PKVBRE. MZHE do të zhvillojë një sistem të monitorimit, duke përfshirë indikatorët për masa dhe instrumente individuale.

Raporti për PKVBRE do të përfshijë: Një analizë të arritjeve kundrejt caktimit shtetëror sipas sektorëve (energji elektrike, ngrohje dhe ftohje, dhe transport) dhe në total, informata për masat e ndërmarra për promovimin e përdorimit të BRE dhe analizën e efikasitetit të tyre, progresin në evitimin e barrierave administrative për prodhimin e energjisë nga BRE, masat për përmirësimin e transmissiionit dhe shpërndarjes brenda sistemit të energjisë elektrike për të mundësuar integrim më të mirë të stabilimenteve që përdorin burime të ripërtëritshme të energjisë, vlerësim të kursimeve të gazrave serrë nga rritja e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme dhe të dhënat tjera përkatëse të nevojshme, sipas nenit 22 të Direktivës 2009/28/EC. Nëse raporti konstaton se caqet në periudhën e mbuluar nga raporti nuk janë arritur, Qeveria do të ndryshojë PKVBRE me masa të reja, apo më të fuqishme për t'i arritur caqet e përcaktuara.